

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6055
E hënë, 5 korrik 2020
çmimi 0.40 €

Kurti: Zgjedhjet e parakohshme janë të domosdoshme



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

QEVERIA E KOSOVËS KA RIKTHYER DISA MASA KUFIZUESE KUNDËR COVID-19

KTHEHET KUFIZIMI I LËVIZJES NË DISA QYTETE, MBYLLEN LOKALET GJATË NATËS

FAQE 4-5



Pas vdekjes së 13 personave brenda 48 orëve të fundit, Qeveria e Kosovës ka rikthyer disa masa për ta parandaluar përhapjen e koronavirusit. Sipas vendimeve të qeverisë, nga e diela janë kthyer kufizimet e lëvizjes në qytetet me numër të madh të të infektuarve, ka filluar shtimi i kapaciteteve mjekësore me shtretër dhe pajisje, duke riorganizuar klinikat e QKUK-së dhe spitalet rajonale. Gjithashtu, do të mbyllet lokalet gjatë natës dhe institucioneve do të punojnë vetëm me staf esencial

FLET PËR "EPOKËN E RE", SAFET GËRHXHALIU

ËSHTË KOHA QË DORA E SHTETIT TË JETË NË FUNKSION TË ZHVILLIMIT EKONOMIK DHE STABILITETIT SOCIAL

Sekretari gjeneral në Forumin Investiv të Odave Ekonomike të Ballkanit Perëndimor në Trieste të Italisë, Safet Gërxhaliu, ka thënë se është koha që dora e shtetit të jetë në funksion të zhvillimit ekonomik, stabilitetit social dhe në funksion të proceseve përsheptuese integrale. Ai ka deklaruar se emëruet i përbashkët i të gjitha problemeve në Kosovë është sundimi i rendit dhe ligjit. Në këtë inter-

vistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka theksuar se deputetët e kësaj legjislature duhet të jenë më seriozë dhe mos ta rëndojnë jetën e qytetarëve dhe punëtorëve të sektorit privat. Në këtë intervistë, Gërxhaliu ka folur edhe për idenë e krijimit të një komisioni hetimor për procesin e privatizimit, duke theksuar se kjo ide nuk duhet të përdoret vetëm popullizëm, por duhet të ketë një analizë të mirëfilltë



AKTUALE



THAÇI VAZHDON VIZITAT TE FAMILJET E DËSHMORËVE F.3

OSMANI: QEVERIA MOS TA MBAJË PENG LIGJIN PËR PARANDALIMIN DHE LUFTIMIN E PANDEMISË COVID-19 F.7

KOSNETTI: POPULLI I SHBA-së DHE KOSOVËS NDAJNË VLERA TË PËRBASHKËTA F.7

EKONOMI



INATET POLITIKE, NË DËM TË EKONOMISË F.6

KRYEMINISTRI KËRKON NGA DEPUTETËT TË MBLIDHEN PËR BUXHETIN F.8

EKONOMI



SHATRI REALIZOI RRUGËTIMIN SFIDUES 257 KILOMETRA NGA PRISHTINA NË TIRANË F.16

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht-Tetovë
Curëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Vazhdon bilanci i rëndë nga Covid-19 në Shqipëri

Në 24 orët e fundit kanë humbur jetën dy pacientë nga Tirana, ndërsa janë regjistruar 74 raste të reja nga 392 testime të kryera. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në Shqipëri u ka bërë thirrje qytetarëve që të tregojnë kujdes për respektimin e rregullave, duke shmangur grumbullimet dhe duke ruajtur distancën me njëri-tjetrin

“Epoka e re”

PRISHTINË, 5 KORRIK - Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në Shqipëri ka bërë me dije se në 24 orët e fundit kanë humbur jetën dy pacientë nga Tirana, ndërsa janë regjistruar 74 raste të reja nga 392 testime të kryera.

Marjeta Dervishi nga Instituti i Shëndetit Publik ka deklaruar se në spital janë 89 pacientë, 11 prej të cilëve në gjendje serioze në terapinë intensive, 1 prej tyre i intubuar në gjendje të rënde. “Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale i drejtohet me një thirrje çdo qytetari: Tregoni kujdes çdo ditë me respektimin e rregullave. Shmangni

grumbullimet. Ruani distancën me njëri-tjetrin. Përdoreni maskën kudo në ambientet e mbyllura, kur hyni në supermarket, në dyqane, në zyrë si dhe në çdo ambient publik ku nuk mund ta ruani distancën. Ruani higjienën personale dhe kolektive”, ka thënë Dervishi teksa ka informuar për situatën epidemiologjike në 24 orët e fundit.

“Dy qytetarë nga Tirana, 67 dhe 69 vjeç, e kanë humbur betejën me sëmundjen në 24 orët e fundit, me gjithë përpjekjet e mjekëve të cilët po bëjnë të pamundurën në Spitalin Infektiv. Një lutje për qytetarët që të tregojnë kujdes sepse rastet në Spitalin Infektiv po



shtohen çdo ditë e më tepër dhe me gjithë të shëruarit që kanë lënë spitalin në 24 orët e fundit, aktualisht janë 89 pacientë në spital, 11 prej të cilëve në gjendje serioze në terapinë intensive, 1 prej tyre i intubuar në gjendje të rëndë. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale u shpreh ngushëllime

familjarëve të të ndjerave”, ka thënë ajo.

Shpërndarja gjeografike e rasteve është si vijon: 22 raste në Tiranë, 12 në Krujë, nga 8 në Pukë dhe Berat, 4 në Vlorë, nga 2 në Shkodër, Durrës, Kurbin, Kavajë, Kamëz, Përmet, Malesi e Madhe dhe nga një rast në Lushnje, Gjirokastrë,

Pogradec, Dibër, Kolonjë.

Sipas Dervishit, në 24 orët e fundit janë shëruar 20 qytetarë, duke e çuar në 1657 numrin e të shëruarve që nga fillimi i epidemisë.

Në Shqipëri aktualisht janë 1160 persona aktivë me Covid-19, kryesisht në Tiranë, Shkodër, Krujë, Durrës.

Basha takon afaristët në Korçë, ua tregon ofertën



KORÇË, 5 KORRIK - Kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, ka qëndruar të dielën në Korçë, ku i ka njoftuar bizneset me tri masat që do të marrë që në ditën e parë kur të vijë në pushtet. Ai ka deklaruar se hapi i parë që do të ndërmarrë do të jetë heqja e inspektorëve të terrenit, të cilët, sipas tij, terrorizojnë bizneset. “Së pari do ta çlirojmë biznesin nga ankthi, nga klima e tmerrshme e biznesit për shkak të terrorit qeveritar dhe administratës duke futur në karantinë inspektoratet. Një vit karantinë për inspektoratet, në mënyrë që këta njerëz mos të përballen me inspektorët që vijnë për xhepat e tyre dhe të pushtetarëve. Së dyti, do të vendosim një sistem taksash konkurrues për rajonin. Për biznesin e vogël do të ketë një taksë, 0.5 % e xhiros vjetore. Çdo

taksë tjetër do të zhduket”, ka thënë Basha, duke përmendur edhe masën e tretë që do ta ndërmerre.

“Së dyti, për biznesin e madh ne do të vendosim taksën e sheshtë 9 % e cila do të synojë që më shumë para të mbeten për investime për hapje vende pune të cilat natyrisht, për çdo vend të ri pune, do të thotë më shumë konsum. Dhe më shumë konsum do të thotë edhe më shumë mundësi, edhe më shumë të ardhura në xhepat e njerëzve, edhe më shumë xhiro për sipërmarrjen, do të thotë nisje e një zinxhiri pozitiv për ekonominë shqiptare. Pa këto masa, ekonomia shqiptare do të vazhdojë të hidhet drejt një gropë gjithmonë e më të thellë, siç është hedhur në këta shtatë vjet”, është shprehur Basha.

Greçia do t'i mbyllë kufijtë për serbët

PRISHTINË, 5 KORRIK - Autoritet greke prej të hënës në orën 6.00 të mëngjesit do t'i mbyllin kufijtë për hyrjen e shtetasve të Serbisë. Ministri serb i Tregtisë dhe

Turizmit, Rasim Lajiq, ka deklaruar se pas kësaj ore asnjë shtetas serb nga cilido shtet nuk do të mund të hyjë në Greqi. Kurse turistët serbë që tashmë kanë hyrë në

shtetin helen do të mund të qëndrojnë deri në fund të prenotimit. Shkak për këtë vendim të autoriteteve greke është numri i rritur i të prekurve nga koronavirusi në

Serbi.

Dhjetë ditët e fundit shumë shtetas serbë nëpërmjet Bullgarisë kanë hyrë në Greqi për t'i kaluar pushimet verore.



LËVIZJA VETËVENDOSJE MBAN MBLEDHJEN E RADHËS TË KËSHILLIT TË PËRGJITHSHËM

Kurti: Zgjedhjet e parakohshme janë të domosdoshme

Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka thënë të dielën se zgjedhjet e parakohshme janë të domosdoshme. Në mbledhjen e Këshillit të Përgjithshëm të LV-së ai ka thënë se sot imuniteti i shtetit është shumë më i dobët sepse legjitimiteti mungon. “Trupi pa imunitet nuk e fiton dot betejën kundër virusit dhe dorëzohet, kurse qeveria pa legjitimitet është e dorëzuar dhe nuk fiton asnjë betejë brenda apo jashtë vendit. Ne duhet t’i forcojmë të dyja, edhe imunitetin e qytetarëve, edhe legjitimitetin e qeverisë me zgjedhje të reja e me qeverisje të mirë”, ka deklaruar Kurti



nënshkrime. Qendrat të cilat janë treguar më efikase në mbledhjen e nënshkrimeve deri më tani janë: Prishtina, Mitrovica dhe Ferizaj”, ka thënë ai.

Lideri i LV-së ka thënë se ky është një vit i pazakontë dhe, sipas tij, deri tani ka pasur shumë të papritura. “Shoqëria dhe shteti ynë duhet të forcohen që t’i bëjnë ballë çdo sfide. Sot imuniteti i shtetit është shumë më i dobët sepse mungon legjitimiteti. Trupi pa imunitet nuk e fiton dot betejën kundër virusit dhe dorëzohet, kurse qeveria pa legjitimitet është e dorëzuar dhe nuk fiton asnjë betejë brenda apo jashtë vendit. Ne duhet t’i forcojmë të dyja, edhe imunitetin e qytetarëve, edhe legjitimitetin e qeverisë me zgjedhje të reja e me qeverisje të mirë”, ka deklaruar Kurti.

Ai ka shtuar se si subjekt politik kanë zgjedhje të dyfishta. “Kemi zgjedhjet e brendshme në Lëvizjen Vetëvendosje në vjeshtë dhe zgjedhjet e domosdoshme të parakohshme për parlamentin e ri dhe qeverinë e re. Zgjedhjet e parakohshme janë të domosdoshme. Më 6 tetor nuk kishim thjesht një palë zgjedhje të radhës dhe nuk kishim thjesht një qeveri të radhës. Qytetarët votuan për ndryshim. Votuan që partitë e PAN-it të shkojnë në opozitë dhe votuan si kurrë më parë me numër rekord të votave se kush duhet të jetë kryeministër”, ka deklaruar Kurti.

EPOKA ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 5 KORRIK - Në mbledhjen e 40 të Këshillit të Përgjithshëm të Lëvizjes Vetëvendosje, kryetari i saj, Albin Kurti, ka thënë se si lëvizje janë rritur në kriza. “Ajo që në Lëvizje ka qenë konstante është përballja e vazhdueshme me krizat të cilat nuk i janë ndarë vendit tonë që nga themelimi i Vetëvendosjes para 15 vjetëve. Këto kriza i kemi përjetuar e përballur së bashku me qytetarët të cilët goditen çdoherë më së keqi dhe kërcënohen më së shumti. Prandaj, takimet tona janë më shumë se procedurë e më shumë se përfaqësim sepse janë çdoherë vendimmarrje në kohë krizash”, ka thënë Kurti. Ai ka theksuar se 6 tetori i vitit 2019 ishte datë historike, ku qytetarët me votën e tyre të lirë

ndryshuan politikën në Kosovë dhe vendosën fatin e politikanëve. “Në frymën e rezultateve të zgjedhjeve, duke respektuar votën e qytetarëve, formuam një qeveri të vogël, por të mençur dhe efikase, një qeveri të kursimit të parasë publike, të luftimit të korrupsionit dhe të shfrytëzimit racional të buxhetit”, është shprehur Kurti, duke shtuar se: “Kështu mbajtëm premtimin për një qeveri të pastër, me njerëz me integritet e të pakorruptuar, me profesionistë, me gra e burra që synim e motiv kanë shërbimin ndaj qytetarëve e jo pasurimin për vete”.

Ai ka thënë se sot Lëvizja Vetëvendosje është bërë subjekti më i madh politik në Kosovën e pasluftës. “Nuk ka ndodhur asnjëherë që nga shpallja e pavarësisë, madje as që nga përfundimi i luftës, që partia fituese e zgjedhjeve të

mbetet në opozitë. Po ashtu, nuk ka ndodhur që partia fituese e zgjedhjeve të mos ketë asnjë nga pozitat udhëheqëse të shtetit. Por, në të njëjtën kohë, si asnjëherë më parë në Kosovë, zgjedhjet i fitoi një parti e cila e do më shumë shtetin e popullin sesa pushtetin dhe vetveten”, ka thënë Kurti, duke shtuar se matjet e opinionit publik e nxjerrin Lëvizjen Vetëvendosje jo vetëm të parën, por edhe me mbi trefishin e mbështetjes krahasuar me vendin e dytë ku bëjnë gara PDK-ja e LDK-ja, kurse mua me mbi katërfishin e preferencës qytetare për kryeministër të vendit krahasuar me të dytin që më vjen nga pas. Një gjë është tejet interesante në këto sondazhe: mbështetja që kemi te gratë është mbi 55 %

(krahasuar me burrat 42 %), ndërkaq te rinia i afrohem 2/3 përkrahjes popullore. Kjo e fundit konfirmon se e kujt është e ardhmja, por e para tregon se çka pritet prej nesh: barazi gjinore, mundësi e drejtësi e pjesëmarrjes për gratë dhe vajzat, në punësim, në pronësi, në pasuri, në udhëheqje”, ka deklaruar Kurti.

Kurti në këtë takim ka folur edhe për peticionin “Duam zgjedhje”. “Më 2 qershor e filluam peticionin ‘Duam zgjedhje’ me lista fizike nëpër qendrat e lëvizjes. Kemi arritur çerek milioni nënshkrime. Pra, duket që si për demonstrata, ashtu edhe për peticione, Lëvizja Vetëvendosje mund t’ia thyejë rekordin vetëm vetvetes. Ky peticion tashmë është peticioni më i madh i Kosovës së pasluftës, por ai duhet të rritet e do të rritet edhe më shumë sesa çerek milioni



Thaçi vazhdon vizitat te familjet e dëshmorëve

PRISHTINË, 5 KORRIK (ER) - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka vazhduar vizitat në familjet e dëshmorëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ai të dielën ka qëndruar për

vizitë në Komoran, te familjet e Ymer dhe Skënder Alushanit. “Në Komoran, me familjet e Ymer dhe Skënder Alushanit. Familja Alushani dha kontribut të shquar për çlirimin e

atdheut. Kosova kudo ka heronjtë e lirisë dhe pavarësisë. Lavdi e përjetshme gjakut të të rënëve!”, ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në “Facebook”.

Një ditë më parë Thaçi ka vizituar edhe familjen Muqolli në Poklek të Drenasit. “Në familjen Muqolli në Poklek të Drenasit, së cilës iu vranë dhe masakruan 40 anëtarë më 17

prill 1999. Gjaku i 54 martirëve të masakrës së Poklekut qëndron në themelet e lirisë dhe pavarësisë së Kosovës. Nderim dhe respekt i përjetshëm”, ka shkruar Thaçi.

QEVERIA E KOSOVËS KA RIKTHYER DISA MASA KUFIZUESE KUNDËR COVID-19

KTHEHET KUFIZIMI I LËVIZJES NË DISA QY



Pas vdekjes së 13 personave brenda 48 orëve të fundit, Qeveria e Kosovës ka rikthyer disa masa për ta parandaluar përhapjen e koronavirusit. Sipas vendimeve të qeverisë, nga e diela janë kthyer kufizimet e lëvizjes në qytetet me numër të madh të të infektuarve, ka filluar shtimi i kapaciteteve mjekësore me shtretër dhe pajisje, duke riorganizuar klinikat e QKUK-së dhe spitalet rajonale. Gjithashtu, do të mbyllen lokalet gjatë natës dhe institucionet do të punojnë vetëm me staf esencial

riorganizuar klinikën e QKUK-së si dhe në spitalet private. Të blejmë edhe shtatë aparatūra shtesë të testimit. Do të krijojmë kapacitete shtesë me personel shëndetësor, duke mobilizuar në nivel vendi edhe ata që nuk janë të punësuar, në veçanti në infermieri e mikrobiologji”, ka thënë ai, duke shtuar se do të synohet të bëhen deri në 500 teste në ditë. “Do të merremi me krijimin e kapaciteteve për testim virulogjik, do të krijohen kapacitetet brenda ditës, deri 500 teste brenda ditës. Do të krijohen kapacitete në regjione. Do të blejmë edhe 100 mijë teste shtesë. Por, do të bëjmë një formë të prioritetit se kush do të testohet. Duhet të kemi edhe buxhetin në dispozicion për t’i siguruar 100 mijë teste, deri në 500 mijë vaksina sezonale, për të siguruar vaksina kundër Covidit në lidhje me protokollin e OBSH-së kurdo që ajo është e gatshme, por edhe për t’i blerë shtatë aparatūra për teste virulogjike”, ka thënë ai.

Më tej, ai ka treguar se do të mbyllen të gjitha lokalet gjatë natës. “Mbyllen të gjitha lokalet e gastronomisë nga ora 21:00 deri në orën 05:00. Jashtë kësaj periudhe lejohet puna

vetëm në hapësira të hapura dhe take away (merre me vete)”, ka deklaruar Hoti. Po ashtu, në institucione do të reduktohet numri i punëtorëve vetëm në stafin e domosdoshëm. Ndërkaq, në institucionet shëndetësore do të reduktohen të gjitha shërbimet që janë joesenciale. Gjithashtu, masat parashohin të përgjysmohen edhe me numrin e personave që përdorin autobusë urbanë.

IKShPK-ja: Virusi është kudo, përmbahuni rekomandimeve

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës sërish të dielën u ka bërë thirrje qytetarëve që t’u përmbahen rekomandimeve dhe se bartja e maskave mbetet obliguese. IKShPK-ja u ka bërë thirrje bizneseve dhe gastronomëve që ta respektojnë distancën fizike, dezinfektimin dhe ajrosjen e lokaleve, duke pamundësuar përhapjen eventuale të infeksionit dhe hapësirat e mbyllura. “Ne po shkojmë drejt një normaliteti të ri. Ky normalitet i ri paraqet ndërrimin e sjelljeve tona për të mirë, për ta mbajtur higjienën,

për ta mbajtur distancën, për ta mbajtur maskën, për të mos përhapur piklat tona të cilat i qesim nga goja çdo ditë, dikush më shumë e dikush më pak, e që rrezikojnë shëndetin e të tjerëve, por në radhë të parë shëndetin e të afërmeve, të familjes, të fëmijëve, të farefisit, të komunitetit, pastaj të gjithë qytetarëve”, është thënë në njoftim.

Ky institut ka treguar se inspektoratet sanitare të AUV dhe inspektoratet komunale bashkë me shtabet komunale patjetër duhet ta zbatojnë Ligjin për Inspektoratin dhe Ligjin për parandalimin e sëmundjeve ngjitëse duke u mbështetur në manualin për luftimin e Covid-19 dhe të merren masa përgjegjësie në çdo rast të moszbatimit eventuale të rekomandimeve të Institutit Kombëtar. “Çdo shkelje e rregullave nga kushdo do të konsiderohet rrezikim i shëndetit dhe jetës së të tjerëve. Nuk ka të drejtë askush të rrezikojë jetën e të afërmeve të tyre, të moshuarve dhe personave me sëmundje kronike për shkak të pakujdesit dhe moszbatimit të rekomandimeve. Vazhdoni ta mbani distancën fizike dhe maskat”, është thënë në njoftim.

EPOKA E RE Muhamet KOCI

PRISHTINË, 5 KORRIK - Qeveria e Kosovës ka vendosur t’i rikthejë disa masa kufizuese për ta luftuar përhapjen e koronavirusit. Në mbledhjen e së dielës, qeveria ka vendosur ta bëjë kufizimin e lëvizjes në qytetet me numër të madh të të infektuarve, t’i shtojë kapacitetet mjekësore për t’u përballur me Covid-19 dhe t’i mbyllë lokalet gjatë natës.

Ndërmarrja e këtyre masave është bërë pasi që gjatë të shtunës dhe të dielës kanë humbur jetën nga koronavirusi 13 persona dhe janë shënuar qindra raste të reja të të

infektuarit. “Është përgatitur një plan i veprimit që sot miratohet në qeveri, që specifikon hollësisht se cilat veprime do t’i ndërmarrin veprimet shëndetësore. Në qytetet me numër të madh të të infektuarve si Prishtina, Prizreni, Ferizaj e Vushtrri do të kthehet masa e kufizimit të lëvizjes prej 21:00 deri në 5:00”, ka thënë Hoti, në një konferencë për media pas takimit me drejtuesit e institucioneve shëndetësore. Hoti ka treguar edhe për masat e tjera që do të miratohen sonte në mbledhjen e qeverisë. “Do të kujdesemi që të krijojmë kapacitete shtesë me shtretër dhe pajisje duke

TETE, MBYLLEN LOKALET GJATË NATËS



Gjendja ka dalë jashtë kontrollit

Partitë opozitare e kanë kritikuar qeverinë për keqmenxham të pandemisë. Lëvizja Vetëvendosje dhe Partia Demokratike e Kosovës kanë vlerësuar se gjendja e pandemisë ka dalë jashtë kontrollit.

Nënkryetarja e Kuvendit të Kosovës nga radhët e LV-së, Arbërie Nagavci, ka vlerësuar se qeveria ka dështuar në kujdesin ndaj shëndetit publik. "Gjendja ka dalë krejtësisht jashtë kontrollit. Qeveria po dështon në kujdesin ndaj shëndetit publik, ndaj ruajtjes së jetës së qytetarëve si e drejtë absolute dhe, po ashtu, ka bllokuar Ligjin për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë Covid-19 që kemi iniciuar që në muajin prill. Ndërkaq studimet po tregojnë se Covid-19 mund të kthehet te i njëjti person edhe pas shërimit. Fatkeqësisht, raste të tilla të konfirmuara për herë të dytë kemi edhe në Kosovë. Pra, të gjithë jemi të rrezikuar, pa marrë parasysh moshën, dhe pasojat mund të jenë të rënda", ka shkruar Nagavci në profilin e vet në "Facebook", duke i ftuar qytetarët që të bëjnë kujdes. "Në këto rrethana më e rëndësishmja është ta ruani

Hoti: 30 për qind e qytetarëve nuk besojnë që ka koronavirus

Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka treguar se në bazë të një hulumtimi, 30 për qind të qytetarëve në Kosovë nuk besojnë se virusi Covid-19 është real. Për këtë qëllim, ai ka thënë se do ta fillojnë publikimin nëpër media të reportazheve ditore nga Klinika Infektive për t'iu treguar qytetarëve se me çfarë përballen të shtruarit në spital e të infektuar me Covid-19. "Do të fillojmë me reportazh të rregullt nga Klinika Infektive, në mënyrë që t'iu tregojmë qytetarëve se me çfarë përballen pacientët. Në bazë të vlerësimeve, 30 % e qytetarëve në Kosovë nuk besojnë se Covidi është real, nuk besojnë se ai është i rrezikshëm. Kjo është e patolerueshme", ka thënë Hoti. Ditë më parë këngëtari dhe ish-deputeti i Kuvendit të Kosovës, Labinot Tahiri, ka deklaruar para mediave se nuk ekziston koronavirusi.

shëndetin personal të familjarëve dhe të gjithë atyre me të cilët keni kontakte. Ruani distancën fizike, kujdesuni për higjienën, përdorni maskat dhe shmangni qëndrimet në ambiente të mbyllura", ka shkruar ajo. Edhe deputetja e PDK-së, Blerta Deliu-Kodra, ka deklaruar se

pandemia ka dalë jashtë kontrollit. "Menaxhimi i pandemisë Covid-19 duket se ka dalë tërësisht jashtë kontrollit. Po e përmend një fakt, të cilin e kanë nënvizuar rregullisht ekspertët e mbarë botës. Çelësi i suksesit të menaxhimit të situatës me pandeminë, para së gjithash, qëndron në besimin qytetar ndaj qeverisë. Ky shpërthim viral, ndikuar edhe nga një klimë 'padëgjueshmërie' qytetare ndaj thirrjeve qeveritare, dëshmon një mungesë të theksuar mirëbesimi ndaj qeverisë", ka shkruar ajo në profilin e vet në "Facebook". Sipas saj, kjo situatë kërkon një riorganizim më të gjerë ndërinstitucional. "Kjo gjendje është e patolerueshme dhe rikuperimi i saj duket kërkon një riorganizim më të gjerë ndërinstitucional për të ndërtuar një plan përgjigjeje ndaj situatës së krijuar", ka shkruar ajo

Ministria e Shëndetësisë jep hollësi për vdekjet e së dielës nga Covid-19

Ministria e Shëndetësisë dhe Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës kanë shprehur keqardhje me rastin e vdekjes së pacientëve të diagnostikuar me Covid-19 në orët e para të mëngjesit të së dielës. Sipas MSh-së, për shkak të shtimit të numrit të vdekjeve brenda një afati të shkurtër kohor janë ngritur dyshime lidhur me natyrën e vdekjes së këtyre pacientëve. Në njoftimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Shërbimit Spitalor thuhet se deri në këto

momente të gjithë pacientët e infektuar me Covid-19 kanë qenë të konfirmuar përmes metodës standarde të aplikueshme të diagnostikimit me Covid-19 dhe kanë qenë në gjendje kritike duke u trajtuar në Klinikën Infektive në QKUK. "Me qëllim që të zbardhet çdo dyshim rreth natyrës së vdekjes së tyre, MSh dhe ShSKUK i bëjnë thirrje publikut dhe të gjithëve që të përmbahen nga konkludimet e parakohshme dhe t'ua japin kohën e duhur institucioneve

përgjegjëse për ta bërë analizën e shkaqeve të vdekjeve dhe t'i nxjerrin përfundimet meritore", është thënë në reagimin e MSh-së, duke treguar se fluksi i pacientëve është rritur së fundi. "ShSKUK konfirmon se fluksi i pacientëve me pasqyrë të rëndë klinike nga Covid-19 është rritur ndjeshëm javët e fundit, ndërsa QKUK-ja ka rritur kapacitetet e Mjekimit Intensiv, me qëllim të trajtimit të të gjithë pacientëve të shtrirë

në spital, pavarësisht ngarkesave të mëdha. MSh dhe ShSKUK i ngushëllojnë familjarët e pacientëve që kanë humbur betejën me Covid-19", është thënë në njoftimin e MSh-së dhe ShSKUK-së. Ky reagim i MSh-së ka ardhur pasi disa familjarë të viktimave të fundit kanë shprehur dyshime lidhur me trajtimin që u është bërë të afërmeve të tyre në Klinikën Infektive. Për këto arsyeje, mëngjesin e së dielës në oborrin e kësaj klinike ishte parë edhe Policia e Kosovës.

Shoqata e të Drejtave të Pacientëve: Lirimi i masave solli gjendjen në prag të kolapsit

PRISHTINË, 5 KORRIK (ER) - Shoqata e të Drejtave të Pacientëve në Kosovë (PRAK) ka reaguar pas lajmit për vdekjen e pacientëve me koronavirus në QKUK dhe rritjes së të infektuarve, duke thënë se "institucionet nuk po arrijnë ta menaxhojnë fluksin e pacientëve". Në një komunikatë për media, PRAK ka kritikuar vendimin për lirimin e masave kundër sëmundjes Covid-19, duke thënë se kjo ka kontribuar që gjendja të bëhet "e pamenaxhueshme". "Kalimi nga masa rigoroze në masa tejet liberale, pa u ngritur kapacitetet spitalore, ka kon-

tribuar që institucionet të vijnë në prag të kolapsit. Është e pashpjegueshme që në kohën kur rriteshin rastet e konfirmuara me Covid-19, masat preventive liroheshin edhe më shumë. Edhe më vështirë i shpjegueshëm është reduktimi i gjurmimit të kontakte të personave të prekur me Covid-19", thuhet në reagimin e PRAK-ut. Duke reaguar për vdekjen e pacientëve në Qendrën Klinike Universitare, kjo shoqatë ka kërkuar që për këtë duhet dhënë përgjigjësi dhe drejtori i Shërbimit Spitalor të Klinikës Universitare të Kosovës, Basri Sejdiu.



Inatet politike, në dëm të ekonomisë



Armand Nisani

Prishtinë, 5 korrik - Inatet ndërmjet partive politike në Kosovë po pamundësojnë ratifikimin e marrëveshjeve financiare ndërkombëtare, thonë përfaqësues të bizneseve. Sipas tyre, mosratifikimi i këtyre marrëveshjeve po pamundëson zbutjen e problemeve ekonomike dhe sociale me të cilat po përballet vendi.

Në dy nga seancat e kaluara, të mbajtura më 11 qershor dhe më 23 qershor, Kuvendi i Kosovës nuk ka arritur ta sigurojë numrin e mjaftueshëm të votave prej 2/3 të deputetëve të pranishëm për ratifikimin e pesë marrëveshjeve ndërkombëtare.

Marrëveshjet ndërkombëtare financiare, të cilat nuk janë ratifikuar në këto dy seanca, kanë të bëjnë me fuqizimin e sektorit financiar pas humbjeve që janë shkaktuar nga pandemia Covid-19 si dhe marrëveshje të tjera për projekte që kanë të bëjnë me trajtimin e ujërave të zeza.

Në pritje për t'i dërguar në kuvend për ratifikim janë edhe disa marrëveshje të tjera ndërkombëtare financiare, të cilat kanë të bëjnë me përballimin me situatën shëndetësore dhe ekonomike, të shkaktuar nga përhapja e sëmundjes Covid-19, që shkaktohet nga koronavirusi.

Këto marrëveshje ende nuk janë shqyrtuar për t'u vënë në rend dite në seancat parlamentare nga kryesia e kuvendit. Sipas të dhënave të Ministrisë së Financave, këto marrëveshje kapin vlerën e rreth 300 milionë euro.

Kryetari i Odës së Afarizmit në Kosovë, Skënder Krasniqi, thotë për "Radion Evropa e Lirë" se, nëse vazhdojnë inatet politike mes partive në opozitë dhe atyre në pushtet, ekonomia do të dëmtohet edhe më shumë.

Ai thotë se ekonomia e Kosovës po kalon në një fazë të vështirë dhe nëse nuk do të arrihet të merren këto fonde që vijnë nga ratifikimi i këtyre marrëveshjeve, atëherë rimëkëmbja ekonomike do të jetë e pamundur. "Ne po shohim një inat të madh mes subjekteve politike pas situatave të krijuara pas rrëzimit të qeverisë së udhëhequr nga Albin Kurti dhe krijimit të qeverisë së re të udhëhequr nga Avdullah Hoti. Por, partitë politike duhet të dinë se këto marrëveshje kanë të bëjnë për përkrahje të qytetarëve dhe bizneseve dhe duhet të ratifikohen. Nga mosratifikimi i këtyre marrëveshjeve po pësojnë qytetarët, të cilët i votuan këto subjekte", thotë Krasniqi.

Partitë opozitare, Lëvizja

Vetëvendosje (LVV) dhe Partia Demokratike e Kosovës (PDK), nuk kanë dhënë mbështetjen e tyre për ratifikimin e këtyre marrëveshjeve.

Hekuran Murati, deputet nga Lëvizja Vetëvendosje, njëherësh kryetar i Komisionit për Buxhet dhe Financa në Kuvendin e Kosovës, pati thënë, në seancën e Kuvendit, se nuk mund të marrin pjesë në votim për një marrëveshje që, siç thotë ai, "i mundëson një qeverie jolegjitime që të shpenzojë dhe të fusë vendin në obligime afatgjatë". "Për më tepër, kur është rrëzuar në mes të pandemisë një qeveri që kishte legjitimitet të plotë popullor, u patën siguruar 82 vota. Mendoj se barra duhet të bjerë mbi qeverinë që të sigurojë këto vota", thotë Murati.

Ndërkaq shefi i grupit parlamentar i PDK-së, Bedri Hamza, ka akuzuar partitë në pushtet për mungesë të bashkëpunimit. "Prioritetet i keni pasur të gabuara. Nuk i keni sjellë në kohë për miratim, nuk keni ofruar bashkëpunim për temat e rëndësishme në këtë kuvend", ka theksuar Hamza, duke shtuar se nuk do të marrin pjesë në votimin e këtyre marrëveshjeve.

Berat Rukiqi, kryetar në Odën Ekonomike të Kosovës, thotë se pjesë e rëndësishme e

rimëkëmbjes ekonomike është edhe ratifikimi i marrëveshjeve ndërkombëtare. Sipas tij, deputetët duhet ta dinë rëndësinë e këtyre marrëveshjeve dhe t'i votojnë ato. "Interesi për ta rimëkëmbur ekonominë e tejkalon çdo agjendë partiake dhe nuk duhet të jetë pjesë e luftës politike ditore. Kam thënë se deputetët nuk e kuptojnë se si ndihet një pronar biznesi apo ndërmarrës, i cili fundin e muajit e pret me shumë probleme financiare duke e ditur që ka një rritje të obligimeve", thotë Rukiqi.

Ministrja e Financave, Hykmete Bajrami, në një intervistë për "Radion Evropa e Lirë" ka thënë se shpreson që në seancën e radhës këto marrëveshje do të trajtohen me prioritet. "Në pritje për ratifikim në Kuvendin e Kosovës janë marrëveshjet që kapin shumën prej 60.2 milionë eurosh. Por, kemi edhe një numër të marrëveshjeve ndërkombëtare, huave që jemi duke i negociuar dhe duke procedurave, të gjitha janë duke u përcjellë në Kuvend", ka thënë Bajrami.

Ende nuk ka ndonjë datë të caktuar se kur do të mbahet seanca e radhës e Kuvendit të Kosovës. Të hënën e kaluar një takim i kryesisë së Kuvendit të Kosovës ishte anuluar pa

ndonjë arsye. Po të njëjtën ditë ishte kërkuar që të bëhej testimi i stafit të Kuvendit për Covid-19, pasi që sekretari i përgjithshëm në Kuvendin e Kosovës, Ismet Krasniqi, dhe deputeti Arben Gashi kanë rezultuar pozitivë me koronavirus.

Mosmiratimi i projektligjeve për ratifikimin e pesë marrëveshjeve ndërkombëtare pati nxitur reagimin e ambasadorit të Gjermanisë në Prishtinë, Christian Heldt. Ai pati kritikuar Kuvendin e Kosovës për këtë gjë. "Fjala zhgënjim është shumë diplomatike. A do ta shohim së shpejti Kuvendin e Kosovës duke punuar? Kjo kishte të bënte me paketat e ndihmës për shtetin dhe popullin", pati shkruar Heldt në një postim në rrjetin social "Twitter".

Ndërkohë edhe shefja e Zyrës së BE-së në Prishtinë, Nataliya Apostolova, ishte shprehur "e zhgënjyer" që kuvendi nuk i kishte miratuar këto legjislacione.

Mekanizmat financiarë ndërkombëtarë në raportet e tyre të publikuar për efektet e pandemisë në ekonominë e Kosovës kanë vlerësuar se janë shkaktuar dëme të mëdha. Banka Botërore në raportin e saj ka paraparë një rënie ekonomike prej 4.5 përqindësh në Kosovë.

Kosnetti: Populli i ShBA-së dhe Kosovës ndajnë vlera të përbashkëta

**EPOKA
ERE**

F. DËRMAKU

PRISHTINË, 5 KORRIK - Me rastin e 244-vjetorit të pavarësisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, ambasadori i saj në Prishtinë, Philip Kosnett, ka thënë se ShBA-ja dhe Kosova ndajnë vlera dhe attribute, duke shtuar se ShBA-ja ka qëndruar pranë Kosovën për ta bërë të pavarur dhe sot vazhdojnë të qëndrojnë së bashku në luftën kundër terrorizmit dhe pandemisë së koronavirusit. "Populli i ShBA-së dhe i Kosovës ndajnë shumë vlera dhe attribute. Populli ynë është i fortë dhe i mençur, kreativ, i dhembshur dhe i shkathët. Si miq, partnerë, ne i jemi përgjigjur njëri-tjetrit kur kemi pasur nevojë. Ne qëndruam së bashku për ta bërë Kosovën të pavarur, qëndruam së bashku pas sulmeve të 11 shtatorit dhe në luftën kundër terrorizmit global. Ne qëndrojmë së bashku

edhe në përballjen me pandeminë globale", ka thënë Kosnett.

Sipas ambasadorit Kosnett, duhet angazhim qytetar që një shtet të ketë demokraci. Ai ka deklaruar se në kohën kur ShBA-ja po përballet me trazira, ku protestuesit po kundërshtojnë racizmin dhe pabarazinë, ka shpresë se do të ndodhin ndryshime pozitive. "Në Amerikë, si në çdo vend, demokracia nuk është sport spektatorësh. Demokracia kërkon angazhim dhe këmbëngulje aktive të qytetarëve. Po ashtu kërkon ndershmëri dhe përlësi për të adresuar dobësitë tona dhe për të mësuar nga dështimet tona. Kjo është kohë e trazirave dhe ankthit në Amerikë, por gjithashtu e shpresës. Ka shpresë se ndryshimet pozitive mund të vijnë vetëm përmes angazhimit qytetar. Dhe e njëjta mund të thuhet edhe për Kosovën", është shprehur ambasadori Kosnett.



Ambasadori amerikan në Prishtinë në adresimin e tij për Ditën e Pavarësisë, theksoi përkushtimin e ShBA-së për të ndërtuar një shoqëri dhe një të ardhme për brezat që do të vijnë. "Në këtë Ditë të Pavarësisë së

ShBA-së, le të zotohemi se do të bëjmë përpjekje për të ndërtuar shoqëri për të ndërtuar një të ardhme të përbashkët duke reflektuar mbi ëndërrta e themeluesve të shtetit amerikan dhe për të përmbushur

detyrimet tona, për brezat që do të vijnë", ka deklaruar Kosnett. Krerët shtetërorë të Kosovës kanë uruar ShBA-në për Ditën e Pavarësisë, duke e falënderuar këtë shtet për përkrahjen e dhënë për Kosovën.

Osmani: Qeveria mos ta mbajë peng Ligjin për parandalimin dhe luftimin e pandemisë Covid-19

**EPOKA
ERE**

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 5 KORRIK - Pas rasteve të fundit, ku vdiqën 13 persona vetëm për dy ditë me Covid-19 në vendin tonë, ka reaguar kryeparlamentarja Vjosa Osmani. "Jetët, edhe kur shtrëngohemi t'i përmbledhim në numra, nuk janë numra, sepse prapa secilës jetë, prapa secilës humbje, qëndron një histori njerëzore, qëndron dhimbja e prindërve për

fëmijët e tyre ose e fëmijëve për prindërit dhe në fund dëshpërimi për humbjen e madhe", ka shkruar Osmani në llogarinë e saj në "Facebook". Ajo u ka shprehur ngushëllime familjeve që kanë humbur më të dashurit e tyre. "Ndaj dhimbjen me secilën familje të prekur dhe lutem që të sëmuret nga virusi të shërohen sa më parë. Bëj thirrje edhe një herë që mbrojtja e të drejtës në jetë të vendoset prioritet mbi prioritetet, sepse as ekonomia e



as fushat e tjera nuk do të mbijetojnë nëse nuk sigurojmë shëndetin e popullatës sonë. Qeveria duhet mos ta mbajë më peng Ligjin për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë Covid-19 të cilin e kemi iniciuar dhe hartuar në Kuvend qysh në prill, por ta sjellë urgjentisht në mënyrë që të mund ta amandamentojmë dhe pastaj miratojmë. Ky ligj është posaçërisht i nevojshëm për t'u dhënë kompetenca shtesë organeve ligzbatuese në

mënyrë që të ndërmerren masa strikte për parandalimin e pandemisë", ka shkruar Osmani. Ajo ka thënë se nuk duhet besuar atyre që thonë se nuk ekziston ky virus. "Ky virus vret. Mos u besoni atyre që thonë se nuk ekziston. Mos u besoni as atyre që e minimizojnë rrezikun. Prandaj të kujdesemi secili për veten e familjet tona duke mbajtur maska, distancë dhe higjienë", ka shkruar kryetarja e Kuvendit, Vjosa Osmani.

Ahmeti: Është koha që një shqiptar ta udhëheqë Qeverinë e Maqedonisë së Veriut

PRISHTINË, 5 KORRIK - Lideri i Bashkimit Demokratik për Integritim (BDI), Ali Ahmeti, në një intervistë për "Radion Evropa e Lirë", ka thënë se kandidati i kësaj partie për kryeministër, Naser Ziberi, do të jetë kandidat mbipartiak. Ahmeti u shpreh i bindur se partia e tij do të dalë fituese në zgjedhjet parlamentare të 15 korrikut dhe shtoi se qeveria e re duhet të drejtohet nga një kryeministër shqiptar. "Pse mos insistojmë? Unë pres një përgjigje nga ata që thonë se pse ne si Bashkim Demokratik për Integritim kërkojmë kryeministër shqiptar dhe jam kureshtar t'i dëgjoj



arsyet e të tjerëve të cilët kanë dalë kundër kësaj ideje. Dhe me kënaqësi dhe padurim i pres arsyet që mund t'i japin ata. E drejtë legjitime po, qytetar i këtij

vendi po, të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me shtetin dhe integritetin e shtetit, sovranitetin e shtetit, të ardhmen e shtetit, të gjitha këto i ka (Naser Ziberi) si

një kandidat për kryeministër shqiptar dhe ku është arsyeja, cila është pengesa që ky vend të mos drejtohet edhe nga një shqiptar. Çfarë ndodhi me Maqedoninë që u drejtua Ministria e Mbrojtjes nga një shqiptar? Përkundrazi, u rrit besimi edhe më shumë nga komuniteti maqedonas te komuniteti shqiptar", ka thënë ai. Ahmeti ka pyetur se: Çka ndodhi me Maqedoninë që u gati se një vit e gjysmë Ministria e Punëve të Brendshme drejtua nga një shqiptar në kohën kur u desh që të menaxhojë situata shumë kritike në këtë vend, pa mbajtur anë, drejtoi një proces shumë

delikat. "Çka i ndodhi Maqedonisë me zgjedhjen e një shqiptari për kryetar të parlamentit? Ai ka drejtuar punët për mrekulli dhe kam dëgjuar vlerësime shumë të mëdha edhe nga pozita, por edhe nga opozita për punën që ka bërë kryetari i parlamentit. Përse tani të mos jetë një kryeministër shqiptar? Që ai si kryeministër të marrë përgjegjësi. Edhe ne jemi ata që i dalim zot këtij shteti. Edhe ne jemi shtetas të këtij shteti. Ky është shteti ynë. Ky është atdheu ynë dhe duam që t'i demonstrojmë aftësitë tona për drejtimin e këtij shteti", ka thënë Ahmeti.



Flet për “Epokën e re”, Safet Gërxhaliu

Është koha që dora e shtetit të jetë në funksion të zhvillimit ekonomik dhe stabilitetit social

Sekretari gjeneral në Forumin Investiv të Odave Ekonomike të Ballkanit Perëndimor në Trieste të Italisë, Safet Gërxhaliu, ka thënë se është koha që dora e shtetit të jetë në funksion të zhvillimit ekonomik, stabilitetit social dhe në funksion të proceseve përsheptuese integruese. Ai ka deklaruar se emërues i përbashkët i të gjitha problemeve në Kosovë është sundimi i rendit dhe ligjit. Në këtë intervistë dhënë për gazetën “Epoka e re”, ai ka theksuar se deputetët e kësaj legjislature duhet të jenë më seriozë dhe mos ta rëndojnë jetën e qytetarëve dhe punëtorëve të sektorit privat. Në këtë intervistë, Gërxhaliu ka folur edhe për idenë e krijimit të një komisioni hetimor për procesin e privatizimit, duke theksuar se kjo ide nuk duhet të përdoret vetëm popullizëm, por duhet të ketë një analizë të mirëfilltë

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

Prishtinë, 5 korrik -
“Epoka e re”: Z. Gërxhaliu, si i shihni rrethanat politike dhe çfarë konsekuencash mund të kenë ato në fushën e ekonomisë?

Gërxhaliu: Në radhë të parë efektet e pandemisë do të jenë të pranishme në Kosovë, mirëpo vendi do të goditet në akseptin ekonomik dhe social. E gjithë këtë e rëndon edhe më tepër mosserioziteti politik në Kosovë. Kjo po na dëmton në

aspektin intern dhe ekstern. Në aspektin intern politikanët e kanë shndërruar parlamentin në shou, ku shumë më tepër mbrohen interesat politike dhe të grupeve të interesit sesa të shtetit, që po ndikojnë edhe në aspektin psikologjik të qytetarët. Në aspektin ekstern Kosova është duke e humbur kredibilitetin dhe mbështetjen ndërkombëtare. Kjo po dekurajon mbështetësit e pavarësisë së Kosovës duke ndikuar dhe në aspektin e investimeve të huaja direkte, si dhe ikjen e diasporës nga

Kosova. Besoj se është momenti që lidhshipi ynë të tregojë pjekuri politike, gjithashtu edhe deputetët të jenë në funksion të zhvillimit dhe përmirësimit të imazhit. Nëse vazhdohet kështu, mund të themi se Kosova është më keq sesa para vitit 2008 dhe për këtë nuk duhet fajësuar qytetarët, por politikbërësit të cilët nuk e marrin këtë punë me seriozitet.

“Epoka e re”: Dhe si qëndron Kosova në këto dy aspekte?

Gërxhaliu: Kosova ka hyrë në vitin 2020 pa qeveri dhe në



mars është miratuar buxheti dhe kishte vështirësi, sepse ishte buxhet pa rezerva shtetërore. E kur krejt kësaj i shtohet fakti se është goditur nga koronavirusi, kemi një fenomen mjaft shqetësues, i cili duhet të analizohet në tre indikatorë: të hyrat në ATK,

Doganë dhe turrja e remintancave nga jashtë. Po ashtu, kemi dhe mosseriozitet institucional në parlament. Shumë marrëveshje nuk janë ratifikuar dhe nuk janë aprovuar ndihma nga institucionet kredibile financiare ndërkombëtare. Kjo

dëshmon më së miri se jemi në një rrugë mjaft të vështirë. Po të bëhet një vështirësi krahasues, vendet e rajonit kanë bërë shumë hapa para nesh në mbështetje të sektorit privat dhe stabilitetit social, kurse ne akoma jemi në fazën e parë kur diskutohet për pakon emergjente për punëtorët e sektorit privat. Ndihma prej 170 eurosh për punëtorët e sektorit privat është dhënë vetëm për një muaj, e kjo dëshmon më së miri se në çfarë shtetë të rëndë është Kosova. Maqedonia është duke e përmbushur strategjinë e katërt, po ashtu edhe Serbia strategjinë e katërt, gjithashtu Bosnja dhe Mali i Zi kanë bërë hapa më të avancuar. Prandaj ne ende jemi në momentumin e parë dhe kemi 250 000 qytetarë të sektorit privat që janë pa paga të cilët vetëm pjesërisht janë paguar. Kemi 25 000 familje me më tepër se 100 000 anëtarë që jetojnë në varfëri të skajshme me vetëm 0.83 centë në ditë. A nuk është kjo një bombë e kurdisur që mund të keqpërdoret dhe shfrytëzohet nga organizatat e ndryshme ndërkombëtare që janë në Kosovë, jo për të mirën tonë, por për ta dëmtuar Kosovën. Andaj, fatin e Kosovës duhet ta marrin në dorë institucionet e Kosovës. Është koha kur dora e shtetit duhet të jetë në funksion të zhvillimit ekonomik, stabilitetit social dhe në funksion të proceseve përsheptuese integruese, mbi të gjitha në të përmirësimit të imazhit të shtetit.

“Epoka e re”: Është paralajmëruar rënie ekonomike, konform kësaj u paralajmërua edhe për ulje pagash për punëtorët e sektorit publik?

Gërzhaliu: Duhet të analizohen mundësitë të cilat do të ndikonin në stabilitetin dhe qëndrueshmërinë sociale. E para duhet të jetë dora e zgjatur e shtetit që duhet gjetur

mekanizma, në rast se nuk ka buxhet atëherë duhet të mendohet që të rritet borxhi publik. E dini se për momentin Kosova ka 19 për qind të GDP-së, që është 1 miliard e 370 milionë euro, që me ligj ka të drejtë të ketë borxhe deri në 40 për qind të GDP-së. Vendet e rajonit kanë borxhe 60 apo 80 për qind varësisht nga situata, prandaj kjo duhet të ketë alternativë dhe për këtë alternativë duhet të bëhet votim në parlament dhe të ketë mbështetje nga deputetët por, si duket, është shndërruar në mision të pamundur. E dyta, duhet të shfrytëzohen mjetet nga partnerët ndërkombëtarë. Dhe, e treta, pse jo të ulen edhe pagat në sektorin publik dhe të krijohej një harmonizim me sektorin privat, pasi bartës i zhvillimit ekonomik nuk është administrata, por sektori privat. Pra, është momenti që për sektorin privat të bëhet më tepër dhe në këtë drejtim duhet të merret modeli qoftë i Sllovenisë apo vendeve skandinave që për ta minimizuar krizën sociale, e kanë bërë një lojë të tillë ose metodë të uljes së pagave që pastaj, pas rimëkëmbjes ekonomike, ato paga të kthehen siç kanë qenë. Duhet të marrim modele nga praktikat më të mira.

“Epoka e re”: Mosratifikimi i marrëveshjeve ndërkombëtare po bëhet në sajë të ndonjë analize apo çështje inatesh politike?

Gërzhaliu: Në Kuvendin e Kosovës nuk flitet më për analiza, por ka më tepër lojë dhe garë se kush në çfarë forme do ta ofendojë njëri-tjetrin dhe kush ka më shumë mundësi për të shantazhuar. Në parlament ka intelektualë që mund ta japin kontributin e tyre në zhvillimin e shtetit. Ky mosratifikim duhet të analizohet në shumë dimension dhe çdo dimension

i trajtuar ka efekte enorme negative. S’mund të ndërtohet ardhmëria e Kosovës duke tentuar të hijezohet e kaluara.

“Epoka e re”: Si e keni parë idenë për rishikim të procesit të privatizimit në Kosovë?

Gërzhaliu: Emërues i përbashkët i të gjitha problemeve në Kosovë është sundimi i rendit dhe ligjit. Nuk duhet të ketë ide që shumë më tepër e hamendësojnë opinionin sesa i zgjidhin problemet. Para rishikimit të çdo procesi duhet të kemi së pari identifikim të shkaktarëve të dëmit. Privatizimi në Kosovë ka qenë proces kancerogjen dhe i ka shërbyer më shumë politikës dhe grupeve të caktuara sesa ekonomisë, pra rritjes së punësimit, mirëqenies dhe bilancit të pagesave. Në këtë drejtim sa më tepër që bëhet një vlerësim i tillë do të jetë në funksion të ardhmërisë, por do të jetë shumë vështirë sepse ka kaluar kohë e gjatë. Besoj se shumë më tepër janë duke u përdorur tema për popullizëm sesa për të bërë një zgjidhje të tillë, mirëpo prapë po them, nëse mendohet të ketë transparencë, atëherë duhet të kemi sundim të rendit dhe ligjit. Shihni se çfarë ka ndodhur me ndërmarrjet që kanë qenë të privatizuara me spin-off special, cilat kanë qenë premtimet e tyre dhe si është e mundur që askush të mos japë përgjegjësi që ato ndërmarrje jo vetëm që e kanë ndërruar destinimin, por janë në funksion të ndërtimit dhe përfitimeve. Në vllugun e procesit të privatizimit Kosova ka qenë eksportuesja më e madhe e mbeturinave metalike. Sot kemi raste që makinat prodhuese nga Kosova i gjeni në Maqedoni, në Turqi, në Serbi dhe në vendet e rajonit. Ato janë të eksportuara si mbeturina metalike dhe a ka dëm më të madh sesa nga ky proces.

Kryeministri kërkon nga deputetët të mblidhen për buxhetin

PRISHTINË, 5 KORRIK - Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, u ka bërë thirrje deputetëve të Kuvendit të Kosovës që të gjejnë mënyrë për ta mbajtur seancën ku do të diskutohej dhe miratohej rishikimi i buxhetit për vitin 2020. Gjatë një vizite në Komunën e Suharekës, me rastin e nisjes së zezonit të korrjeshirjeve, Hoti ka thënë që sa më parë nevojitet të kalohet buxheti në Kuvendin e Kosovës në mënyrë që të nisë zbatimi i masës për rimëkëmbjen ekonomike. “Me këtë rast unë dëshiroj t’i lus të gjitha grupet parlamentare, të gjithë

deputetët, që të organizohen në këtë kohë të pandemisë, e di që disa prej deputetëve janë të prekur nga kjo, si dhe stafi i Kuvendit por, të gjejnë mënyra e forma se si mund të mbahet një seancë e Kuvendit, që sa më parë ta kalojë buxhetin si dhe marrëveshjet ndërkombëtare që janë të lidhura me fondin për rimëkëmbje”, ka thënë Hoti. Qeveria e Kosovës javën e kaluar ka vendosur një sërë masash për ta parandaluar përhapjen e mëtejshme të koronavirusit. Një nga këto masa është edhe ndalimi i grumbullimit të më shumë se 50 personave në

çfarëdo ambienti. Qeveria e udhëhequr nga Avdullah Hoti ka prezantuar më herët masat e rimëkëmbjes ekonomike, pas përhapjes së pandemisë së koronavirusit. Fondi i rimëkëmbjes ekonomike është parashikuar të jetë mbi 380 milionë euro. Por, paraprakisht, duhet që buxheti i këtij viti të rishikohet dhe miratohet nga deputetët e Kuvendit të Kosovës. Në qershor, deputetët dështuan që të ratifikojnë një sërë marrëveshjesh ndërkombëtare financiare që do të mundësonin realizimin e pakos për rimëkëmbjen ekonomike. Këto



marrëveshje janë në vlerë prej 253 milionë eurosh. Për shkak të pandemisë së koronavirusit,

Banka Botërore në një raport ka paraparë një rënie ekonomike prej 4.5 përqindësh në Kosovë.

Haziri kërkon respektim të rekomandimeve të shtetit për masat mbrojtëse kundër Covid-19

GJILAN, 5 KORRIK (ER) - Komiteti për menaxhimin e emergjencave në Gjilan, në kuadër të parandalimit të pandemisë globale Covid-19 dhe në bazë të rezultateve të fundit nga Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik, kërkon respektimin e rekomandimeve të institucioneve shëndetësore dhe vendimeve të Qeverisë së Kosovës në mënyrë që të kemi sa më pak raste pozitive dhe normalizim të gjendjes.

Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka njoftuar se në ditën e 117 të përbaljes me pandeminë globale, ka gjithsej 186 raste pozitive, prej të cilave 129 janë shëruar plotësisht, 53 raste janë ende aktive dhe nën monitorim të vazhdueshëm

nga ekipet mjekësore dhe, fatkeqësisht, katër qytetarë kanë humbur jetë deri më tani. Në bazë të njoftimit që ai ka dhënë, bëhet me dije se edhe 46 mostra janë në pritje të testimit në Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik dhe rezultatet e tyre do të publikohen këto dy ditë.

Kryetari Haziri ka kërkuar nga qytetarët e Gjilanit që edhe më tutje nivelin e kujdesit ta kenë maksimal sepse, siç ka thënë ai, asgjë nuk ka përfunduar dhe respektimi i rekomandimeve të institucioneve shëndetësore për masat mbrojtëse është e vetmja zgjidhje dhe e domosdoshme karshi armikut të pamëshirshëm Covid-19.



Vazhdon mirëmbajtja e parkut rekreativ 'Te pishat' në Sllatinë

Fushë-Kosovë, 5 korrik (ER) - Ka disa ditë që ekipet mobile të Komunës së Fushë-Kosovës dhe KRP "Pastrimi" janë duke u marrë me pastrimin e hapësirave të

Parkut Rekreativ "Te Pishat" në Sllatinë. Komuna përmes një njoftimi për media ka bërë me dije se mbeturina të shumta të hedhura vend e pa vend nga qyte-


tarët po ndikojnë në një pamje jo të mirë të këtij kompleksi shumë atraktiv dhe ndër të paktët në këtë regjion. "Andaj edhe kërkesa e shërbimeve përkatëse komunale

është që qytetarët t'i mirëmbajnë këto hapësira dhe mbeturinat t'i hedhin në vendet e caktuara dhe jo në sipërfaqet e gjelbra. Gjithashtu, luten qytetarët që të

mos i dëmtojnë ulëset, rekuizitat e ndryshme sportive si dhe pajisjet e lojërave për fëmijë", thuhet në njoftimin e komunës së Fushë-Kosovës.



Së shpejti do të fillojë rregullimi i hyrjeve të objekteve banesore në Podujevë



PODUJEVË, 5 KORRIK (ER) - Nënkryetari i Komunës së Podujevës, Nexhmi Rudari, ka bërë me dije se së shpejti do të fillojë rregullimi i hyrjeve të objekteve banesore në qendër të qytetit. Ai ka treguar se projekti përfshin ngjyrosjen, suvatimin, dritaret, ndriçimin dhe

vendosjen e dverve me sistem të hapjes me kartelë. "Kjo është vetëm faza e parë e projektit, ndërsa në fazën e dytë do të trajtohen edhe objektet e tjera banesore si dhe do të shikohen ato që i plotësojnë kushtet për vendosjen e ashensorëve", ka thënë Rudari.

Rregullohet hapësira publike edhe te rrethrotullimi në Studençan

SUHAREKË, 5 KORRIK (ER) - Ambient i mirë dhe i bukur po bëhet edhe te rrethrotullimi në hyrje-dalje të fshatit Studençan në Komunën e Suharekës. Kryetari i Komunës së Suharekës, Bali Muharremaj, ka premtuar se do të

angazhohet që kjo komunë të bëhet, më e bukura dhe më e veçanta në Kosovë. "Gradualisht ne do ta bëjmë Komunën e Suharekës, vendin më të veçantë në Kosovë", ka thënë Muharremaj.



NACIONALIZIMI I VAKSINAVE NDAJ COVID-19 DHE KRIJIMI I NJË ALTERNATIVE TJETËR

NJU JORK, 5 KORRIK - Konkurrenca për burimet për të luftuar pandeminë Covid-19 po shqetëson aktivistët se vendet me portofol më të madh do të rrëmbejnë furnizimet dhe do t'i lënë të tjerët pas.

Kjo ka ndodhur tashmë me pajisjet mbrojtëse personale. Në prill, administrata e Presidentit Trump urdhëroi prodhuesin e maskave 3M që të ndalonte eksportimin e maskave N95 në Kanada dhe Amerikën Latine.

Javën që lamë pas, Departamenti Amerikan i Shëndetësisë njoftoi se kishte siguruar gati të gjithë furnizimin me remdesivir, ilaçin e parë të ri anti-Covid-19, nga prodhuesi. "Ky është një paralajmëruar i gjërave të këqija që do të vijnë nëse nuk ekspozohet dhe nuk dalin ide të reja për këtë", ka thënë profesori i drejtësisë i Universitetit Northeastern, Brook Baker, analist i politikave për Projektin e Qasjes Globale në Shëndetësi.

Dozat e para

Në të gjithë botën, qeveritë po përpunojnë sigurojnë qasjen në vaksinat kundër Covid-19 që ende nuk janë vërtetuar se janë të sigurta ose efektive.

Shefi ekzekutiv i kompanisë farmaceutike Sanofi, Paul Hudson i tha rrjetit Bloomberg News se 30 milionë dollarët që Shtetet e Bashkuara kishin investuar në vaksinën e kompanisë, nënkuptojnë që amerikanët do të marrin dozat e saj së pari, nëse ajo funksionon. Hudson u tërhoq nga ky koment një ditë më vonë pas kritikave nga qeveria e Francës, ku është qendra e kompanisë Sanofi.

Në Britani, sekretari i biznesit Alok Sharma ka pohuar se vendi i tij do të marrë 30 milionë dozat e para të vaksinës që po testohet nga Universiteti i Oksfordit dhe prodhuesi i ilaçeve AstraZeneca dhe do të kontribuonte 80 milionë dollarë në përpjekjen e tyre. Katër ditë më vonë, qeveria e Shteteve të Bashkuara njoftoi një marrëveshje prej 1.2 miliardë dollarësh për të siguruar 300 milionë doza të së njëjtës vaksinë. Kompanitë kanë kapacitete prodhuese në shumë vende, kështu që "ne në asnjë mënyrë nuk po pengojmë pjesën tjetër të botës të marrë këto vakcina", tha një zyrtar i lartë i administratës së Presidentit Trump gjatë një telekonferencë më 16 qershor me gazetarët. Rregullat themelore të administratës ndalojnë zbulimin e emrit të zyrtarit.

Virusi u përhap përmes



udhëtimeve ndërkombëtare, pranoi zyrtari, duke shtuar se: "Le të kujdesemi së pari për amerikanët. Deri sa të arrijmë në pikën kur të kemi tepriçë (të vaksinave), sepse është në interesin tonë që të sigurohemi që njerëzit në të gjithë botën të jenë vaksinuar".

Nacionalizimi i vaksinave nuk është i kufizuar vetëm në botën perëndimore.

Instituti Serum i Indisë gjithashtu ka një marrëveshje për prodhimin e 60 milionë dozave të vaksinës së Universitetit të Oksfordit dhe kompanisë AstraZeneca. "Shumica e vaksinave, të paktën fillimisht, do të duhet të jetë në dispozicion të shtetasve tanë përpara se të eksportohet jashtë vendit", ka deklaruar drejtori menaxhues Cyrus Poonawalla për agjencinë e lajmeve "Reuters", megjithëse ai theksoi se qeveria e Indisë do të merrte vendimin përfundimtar.

Bota e ndërlidhur

"Kjo sjellje nuk është e re. Ne e kemi parë këtë më parë pothuajse në çdo pandemi", ka pohuar Rebecca Weintraub, drejtoresh e Projektit të Shëndetësisë Globale në Universitetin e Harvardit.

Ajo ka thënë se vendet e pasura bënë porositë paraprake edhe për vaksinat kundër gripit H1N1 gjatë pandemisë së vitit 2009, duke lënë jashtë vendet e varfra. "Vendet më të pasura në fund u dhanë vakcina vendeve me të ardhura të ulëta, por vetëm pasi ishin të sigurta se kishin vakcina të mjaftueshme për veten e tyre", tregon ajo.

Por në një botë të ndërlidhur, thonë ekspertët, çdo sëmundje është vetëm një udhëtim me aeroplan nga përhapje në një

vend tjetër. "Duhet ta kuptojmë që vendet më pak të përgatitura paraqesin një rrezik global shëndetësor për të gjithë ne" ka theksuar Thabani Maphosa, drejtor menaxhues në organizatën Gavi, nisma globale e vaksinave.

Autoritetet globale shëndetësore po punojnë për krijimin e një alternative të vlefshme ndaj nacionalizimit të vaksinave.

Në fund të prillit, Organizata Botërore e Shëndetësisë filloi një projekt për qasjen në mjetet kundër Covid-19 për të shpejtuar prodhimin dhe shpërndarjen e barabartë të ilaçeve, vaksinave dhe testeve. "Avantazhi i këtij lloji të parimit të centralizuar të shpërndarjes është se ne do t'i japim fund pandemisë më shpejt", ka thënë Rebecca Weintraub nga Universiteti i Harvardit. "Ne do të kthehemi në një ekonomi më të gjallëruar", thotë ajo.

Klub vaksinash

Shumë detaje janë ende duke u përpunuar. Sektori i vaksinave synon të veprojë si një klub blerësish. Vendet vendosin para në një fond të përbashkët që mbështesin zhvillimin e disa vaksinave menjëherë. Meqenëse shumica e vaksinave dështojnë para se të arrijnë në treg, mbështetja e disa prej tyre është një mënyrë për të mbrojtur bastet.

"Të kesh në dispozicion më shumë se një vaksinë do të thotë të kesh konkurrencë, që mund të çojë në uljen e çmimit", ka theksuar Maphosa nga organizata Gavi. GAVI është bashkëudhëheqëse e seksionit të vaksinave të projektit të qasjes së përsheptuar tek vaksinat, ACT

Accelerator. "Organizata gjithashtu u jep prodhuesve një ide mbi sasinë e vaksinave që duhet të prodhohen dhe infrastrukturën që u duhet për ta bërë këtë", shtoi Maphosa. Vendet kontribuojnë në fond duke u bazuar pjesërisht në numrin e qytetarëve të tyre me të rrezikuar, përfshirë punonjësit e kujdesit shëndetësor, të moshuarit dhe njerëz me kushte të tjera shëndetësore që i vendosin ata në rrezik më të madh.

Sistemi me dy nivele

Nuk do të ketë mjaft vakcina fillimisht për të gjithë ata që kanë nevojë për të. Pra, vendet që paguajnë në fond do të marrin vakcina të mjaftueshme për të imunizuar deri në 20 për qind të popullsisë së tyre.

Vendet me të ardhura të ulëta do të mbështeten tek donatorët për koston. Këto vende do të marrin vakcina bazuar në një kornizë që Organizata Botërore e Shëndetësisë është duke e krijuar për t'i dhënë përparësi punonjësve të kujdesit shëndetësor dhe grupeve më të pambrojtura.

Ky sistem me dy nivele ka ngritur shqetësimet në mesin e aktivistëve. Numri i njerëzve të mbuluar në vendet me të ardhura të ulëta do të ndryshojë nga një vend në tjetrin, por "sigurisht që është më pak se 20 për qind e popullsisë (së tyre)", ka thënë Baker.

Projekti ACT Accelerator synon të sigurojë 2 miliardë doza të vaksinës deri në fund të vitit 2021. Dozat do të ndahen në mënyrë të barabartë midis vendeve që kanë paguar për ato dhe vendeve për të cilat donatorët kanë paguar.

Por popullsia e vendeve me të ardhura të ulëta dhe të mesme që ka të ngjarë të marrë mbështetje nga donatorët është shumë më e madhe se ajo e vendeve me të ardhura më të larta që do të paguajnë vetë për vaksinat e tyre. "Njerëzit në vendet e pasura do të kenë pesë herë më shumë mundësi për qasje (tek vakcina) sesa njerëzit në vendet e varfra", është shprehur Baker.

"Nuk është aq keq sa duket. Ndarja e vaksinës supozohet të jetë e bazuar në përgjigjen ndaj kërcënimit të sëmundjes dhe grupit të njerëzve të pambrojtur. Në këtë pikë të veçantë, kërcënimi ka qenë i madh në Perëndim", thotë Maphosa nga organizata Gavi.

Një vend përfundimor si Italia, e cila u godit rëndë nga virusi, ka një popullsi shumë të moshuar, dhe Afrika ka një popullsi shumë të re, vuri në dukje ai. "Dhe kjo është një sëmundje që po rrezikon të moshuarit", ka thënë ai.

Projekti ACT Accelerator ka siguruar premtime prej 3.4 miliardë dollarësh nga 31.3 miliardë dollarë që vlerëson se janë të nevojshme për vaksinat, trajtimet dhe testet. Shtetet e Bashkuara nuk kanë premtuar mbështetje financiare, megjithëse ekspertët e tyre teknikë janë duke kontribuar.

Presidenti Donald Trump ka thënë se ai synon të ndërpresë lidhjet me Organizatën Botërore të Shëndetësisë për përgjigjen e saj jo të mirë ndaj pandemisë.

Deri më tani, një prodhues i vaksinës, AstraZeneca, ka njoftuar planet për të marrë pjesë në këtë program. Kompania thotë se do të japë 300 milionë doza për projektin deri në fund të vitit. (Steve Baragona / Voa)

Raporti i OBSH-së: Rekord i ri rastesh ditore me Covid-19

GJENEVE, 5 KORRIK- Organizata Botërore e Shëndetësisë ka raportuar një rritje rekord të rasteve të koronavirusit në glob, me 212 326 raste të regjistruara në vetëm 24 orë, në mesin e një rritjeje të madhe në ShBA, Brazil dhe Indi.

Raporti për situatën e OBSH-së, tregon se rreth 130 mijë e këtyre rasteve të reja janë në kontinentet amerikane, ShBA, Brazil dhe Meksikë, por OBSH-së thekson se Azia juglindore, përfshirë Indinë, ka regjistruar

të shtunën 28 mijë raste të reja. Shifra më e lartë e rritjes së numrit global të të infektuarve, ishte 189 mijë, e regjistruar të martën.

Ndërsa në ShBA, presidenti Donald Trump flet për fitore të Amerikës ndaj virusit, rastet atje vazhdojnë të rriten. Sipas tij, vetëm 99 për qind e rasteve të identifikuar nga testimet janë totalisht të padëmshëm. Por në shumë shtete shifrat rriten frikshëm me rekorde të reja ditore të raportuara në Karolinën e Veriut, atë të Jugut,



Tenesi, Teksas, Alaskë, Misuri, Ajdaho dhe Alabama.

Sipas universitetit Johns Hopkins, numri i infektimeve në ShBA ka kaluar 2.38 milionë. Në Brazil ndërkohë janë mbi 1.6 milionë të infektuarit dhe 64 265 viktimat. Meksika regjistroi një tjetër rekord të shtunën duke u renditur e pesta në botë për sa i takon numrit të viktimitave. Ajo ia kaloi Francës me 30366 viktima të Covid-19, me infektimet që kanë shkuar në 252165 mijë.

Spanja rikthen masat e izolimit



MADRID, 5 KORRIK- Qeveria në rajonin spanjoll të Katalonisë janë rivendosur kontrollat kundër koronavirusit, në një zonë të banuar prej 210,000 personash, për shkak të rritjes së numrit të infektimeve.

Presidenti i këtij rajoni, Quim Torra ka thënë se askush nuk do të lejohet të hyjë apo të dalë nga Segria, një zonë bujqësore në perëndim të Barcelonës, që përfshin edhe qytetin Lledia. "Ne po ndërmarrim këto hapa

për të mbrojtur veten dhe për të kontrolluar shpërthimin e koronavirusit", ka deklaruar Torra.

Masat e izolimit nisin pasditen e së shtunës. Po ashtu, qytetarët që nuk jetojnë në këtë zonë, do të lejohen që të largohen.

Në Spanjë është raportuar për 400 infektime të reja dhe dy viktima nga sëmundja Covid-19, që shkaktohet nga koronavirusi. Vetëm në qytetin Lledia, janë regjistruar 155 raste

të reja me koronavirus.

Për zbatimin e këtyre masave izoluese, policia do të përkujdeset. Në këtë zonë, po ashtu është ndaluar tubimi i më shumë se dhjetë personave.

Në përgjithësi, Spanja ka shënuar 28,385 vdekje nga koronavirusi.

Ky shtet ka rihapur kufijtë e tij me vendet e Bashkimit Evropian dhe Mbretërinë e Bashkuar, me qëllim që të ringjallë turizmin.

Rusia mohon se po bisedon me ShBA-në për zgjerimin e G7-s

MOSKË, 5 KORRIK- Rusia nuk është duke biseduar me Shtetet e Bashkuara lidhur me zgjerimin potencial të G7, grupit të vendeve më të industrializuara, në samitin që pritet të mbahet më vonë gjatë këtij viti. Kështu ka thënë zëvendësministri i Jashtëm rus, Sergei Ryabkov. "Ne nuk kemi pasur negociata të këtij lloji dhe nuk do të kemi", ka thënë ai për agjencinë TASS.

Komentet e Ryabkov bien ndesh me komentet e ambasadorit të ShBA-së në Rusi, John Sullivan, i

cili më 3 korrik ka deklaruar për RBC TV se Uashingtoni "është angazhuar me Ministrinë e Jashtme ruse dhe me qeveritë e tjera të vendeve të G7, lidhur me atë se nëse duhet të ketë rol për Rusinë në G7".

Presidenti amerikan, Donald Trump ka ngritur idenë e rikthimit të Rusisë në grupin e vendeve më të industrializuara gjatë muajit maj, kur ai njoftoi se takimi i G7 do të shtyhej për në shtator për shkak të pandemisë së koronavirusit.

Trump po ashtu kishte deklaruar se ai do të ftojë edhe Australinë, Rusinë, Korenë e Jugut dhe Indinë në këtë samit.

Rusia, që ka qenë pjesë e këtij grupi, u përjashtua nga ai, pasi aneksoi paligjshëm gadishullin ukrainas të Krimesë në vitin 2014. Trump kishte thënë se është normale që presidenti rus, Vladimir Putin të ftohet që t'i ribashkohet grupit, por shtetet e tjera të G7-s, si Kanada dhe Franca, kanë kundërshtuar këtë ide.



Erdogani: Turqia dërgoi ndihma kundër virusit në 138 vende



STAMBOLL, 5 KORRIK- Presidenti Recep Tayyip Erdogan ka bërë me dije se deri më sot Turqia ka dërguar ndihma mjekësore në 138 vende në mbështetje të luftës së tyre kundër pandemisë së koronavirusit. "Ne kemi dërguar pajisje mjekësore dhe furnizime në 138 vende, pavarësisht fesë, gjuhës, racës ose rajonit", ka deklaruar Erdogan në

ceremoninë e inaugurimit të një spitali të ri shtetëror në Stamboll.

Duke theksuar se përpjekjet shembullore të Turqisë kundër virusit hodhën themelet për mundësi të reja në turizmin mjekësor, ai shtoi se: "Ne jemi të vendosur ta bëjmë Turqinë qendrën shëndetësore të tre kontinenteve", duke iu referuar Azisë, Evropës dhe Afrikës. "Falë

masave që kemi marrë dhe metodave që kemi zhvilluar, ne jemi ndër vendet që kaluan epideminë me humbjen më të vogël të jetëve", ka thënë ai.

Duke folur për spitalin e ri shtetëror dr. Lutfi Kirdar në rrethin Kartal të Stambollit, Erdogan tha se pritet që në këtë spital të kryhen rreth 100 mijë operacione në vit, veçanërisht operacione të kancerit.

Indiani beson se maska e floringjtë 4 000 dollarë e mbron nga Covid-19

New Delhi, 5 korrik- Një nga mjetet kryesore të luftës globale kundër pandemisë Covid-19 është maska e fytyrës. Por në Indi një burrë ka zënë titullin e parë të medieve për një maskë unike që zotëron, për

të cilën ka besim të plotë se nuk do e lejojë që të infektohet me koronavirus. Biznesmeni Shankar Kurhade nga qyteti perëndimor i Punes, ka blerë një maskë të floringjtë për rreth 4,000 dol-

larë. "Është një maskë e hollë që ka vrima të vogla dhe më ndihmon të marr frymë. Meqenëse është e floringjtë kam besim se do të më mbrojnë nga koronavirusi", ka pohuar ai.

Ai ka treguar se njerëzit kërkojnë të bëjnë foto me të. "Ata çmenden fare prej maskës time, sidomos kur e vesh nëpër tregje ose vende me njerëz", ka treguar Kurhade.



Nuk e di nëse unë jam duke qëndruar kokëposhtë apo bota është përmbys!?

Mbi monodramën
"Vrasja e mushkonjës"

Nga: Zyrafete SHALA

Ditë më parë, Shtëpia Botuese "Armagedoni" botoi monodramën "Vrasja e mushkonjës" të poetit Xhevdet Bajraj, vepër kjo që edhe pse e shkruar qysh në vitin 2010, vazhdon të jetë aktuale sot, ashtu siç ndodh rëndom me krijimet artistike që trajtojnë dilemat dhe përjetimet njerëzore në planin universal. E ndërtuar sipas konventave zhanrore, "Vrasja e mushkonjës" vjen si rrëfim subjektiv i protagonistit, monologu i të cilit në fakt paraqet eksternalizimin e tendosjes dhe konflikteve psikologjike të tij, që shfaqen si përgjigje ndaj realitetit. Drama psikologjike e personazhit, që zë fill në pamundësinë e frymimit me aritminë e kaosit që e rrethon, duket që merr përmasat e tensionit të theksuar frustrativ: *Nuk e di nëse unë jam duke qëndruar kokëposhtë /apo bota është përmbys.* Në këto dy vargje mjeshtërore/antologjike autori jep esencën e dezintegrimit të personalitetit, të personazhi i tij, tek i cili shohim prototipin e njeriut që nuk gjen hapësirë për realizimin e ego-idealeve në mjedisin ku jeton.

Pamundësia e ndjekjes së shpërfytyrimit dhe kundërnatyrshmërisë së realitetit, që rrezikon ta kthejë njeriun në një krijesë pa imagjinatë, shtron domosdoshmërinë e kërkimit të shkaqeve në momentet që shënojnë devijimin e njerëzimit nga natyra e tij, apo kërkimin në përsiatjet rreth jetës e të jetuarit, nëpër të cilat rrugëton personazhi, krahas rrugëtimit brenda vetes. Observimet e tij, rreth realitetit aktual dhe të kaluarës përshkohen nga ironia e fuqishme që shpeshherë arrin deri në sarkazëm, duke krijuar situata të jashtëzakonshme, që shpërfaqin degradimin e realitetit deri në një absurditet ku është e vështirë të gjejmë qetësi njerëziteti që ëndërrojnë një jetë normale. Endja nëpër periudha të ndryshme të së kaluarës, është edhe një përpjekje e personazhit për të gjetur strehim nga trazimet e tij, por vështirimi në retrospektivë vetëm sa e thellon edhe më shumë gremimin mes tij dhe asaj që konsiderohet njerëzore. Jo rastësisht rrëfimi nis me poezinë, trajtën sublime



Shevdet Bajraj

të shpalosjes së botës së brendshme, për më tepër me një poezi që shpërfaqë pamjen e trishtë të botës ku njerëzit, si qenie superiore të saj, garojnë për të tejkaluar njëri-tjetrin në egërsi dhe destruktivitet.

Preokupimet e personazhit, megjithëse pikënisjen e kanë gjithnjë brenda kufijve kombëtar, herë pas here i tejkalojnë ata, prandaj edhe shqetësimet e personazhit janë njëlloj të kapshme për çdo njeri, pavarësisht se në cilin skaj të botës jeton. Rrëfimi i tij ngjan me një kolazh të ndërtuar me fragmente të historisë njerëzore, ku është vështirë të gjenden *gjurme sado të vogla të paqes.* Në zërin e tij përmbledhet pakënaqësia e të gjitha qenieve që kanë shijuar kupën me helmin e kësaj bote, qofshin ata njerëz apo krijesa të tjera të pafajshme. Ai është e njëlloj i brengosur si për *klithjen e lules që po lind, si për vajin e pëlumbeshës nënë për të birin që i ngec fluturimi në fytyrë, për kafshët që mbijetojnë në kopshte zoologjike, të tjerat që notojnë në valët brenda konservave, apo ato që janë futur me forcë brenda zorrëve të veta.* Dhimbja e tij shtrihet më tej të njerëzitetit që duke i ndjekur ëndrrat e tyre, për një botë më njerëzore, edhe pse të strehuar brenda manastireve të poezisë, u bënë pre e diktatorëve që e ushqenin 'paqen' me gjak njerëzish të shquar. Doemos që përballë një bote të tillë personazhi i monodramës ndihet i pafuqishëm, prandaj si reagim kërkesat e tij ndaj jetës i tërheq brenda vetes dhe gjen siguri brenda mureve të shtëpisë.

Vendi i zgjedhur për strehim del të jetë i pasigurt, sepse aty duhet të përballet me mushkonjën dhe


gruan e tij, njëra, krijesë shumë e vogël por që i shkakton shqetësime të mëdha dhe tjetra, personi që ai i dhuroi dashurinë e tij; relacioni me to e përbën konfliktin themelor të monodramës, ku personazhi vihet në situata sa komike aq edhe tragjike. Pamundësia për t'u mbrojtur nga një insekt aq i vogël si mushkonja dhe përpjekja për ta përballuar mllëfin e gruas që e bëri ta njohë dashurinë, tregojnë se ai është i humbur në luftën e tij kundër maliciozitetit që mbizotëron atje, në botën e madhe, jashtë shtëpisë së tij. Kjo sepse në një shoqëri *ku e vërteta u takon gjithmonë atyre që qeverisin* pa turp, nën moton *In Gold We Trust*, njerëzit që besojnë në të mirën e përgjithshme, deshën apo jo

duhet të përdorin frenimin e ambicieve dhe ëndrrave, si mekanizëm mbrojtës, frenim ky që shpesh rezulton me shfaqjen e një disekuilibri emocional e psikologjik, që tregon se fati i tyre është i destinuar të jetë tragjik.

Akti përmbyllës i monodramës dhe dialogu që e rrëfen personazhi, i zhvilluar me njerëzitet që vijnë ta arrestojnë, mbetet të vendoset nga lexuesi nëse është real, apo i takon sferës së halucinacioneve, që vijnë si rrjedhojë e përshkallëzimit të çrregullimit, ashtu siç mbetet të vlerësohet edhe vetë gjendja e personazhit, nëse është i dehur apo ka pësuar ndonjë çrregullim emotiv. Por, një gjë është e sigurt, personazhi është i vetëdijshëm se ashtu si shumica e njerëzve, edhe ai vetë,

ka lindur në një tregim të *Gogolit*. Me këtë aluzion që na shpie në tregimin *Shënimet e një të çmenduri* të Gogolit, autori Xhevdet Bajraj, i sugjeron lexuesit një zgjidhje të këtyre dilemave. Personazhi i monodramës mund të shihet si një Poprishin i kohës sonë, një qytetar i botës, që duke shfaqur si produkt i deformimeve të saj epokë pas epoke, me zërin dhe klithmën e tij synon të zgjojë ndërgjegjen e fjetur të njerëzimit.

Monodrama "Vrasja e mushkonjës" është e shkruar në vargje, sepse për autorin Xhevdet Bajraj vargjet janë truallit që i mundëson hapësirën e nevojshme për t'i shtrirë pakufi krahët e imagjinatës, ashtu siç janë Kosova dhe Rahoveci toposet e përzgjedhura të poetikës së tij. Stili sublim, veçori tjetër e krijimtarisë së autorit, e përshkon fund e krye monodramën duke e bërë leximin të mjaftueshëm për të shijuar vlerat estetike të saj, pa qenë nevoja të ndiqet domosdoshmërisht e luajtur në skenë. Vlerësimi korrekt i ecjes së shoqërisë shqiptare nëpër shtetun e gjatë të shtet-ndërtimit, kritikë që nuk e kursejnë asnjë subjekt që keqpërdorë pushtetin, madje sa popullin që i përcjell me indiferencë lojëtar që bëhen në kurrizin e tij, krahas realizimit të lartë artistik, e bëjnë veprën e Xhevdet Bajrajt një barometër të gjendjes në të cilën ndodhemi. Prandaj edhe "Vrasja e mushkonjës", si pjesë e opusit të tij krijues, është një kryevepër e letërsisë shqipe në zhanrin që i takon.



Xhevdet Bajraj ka lindur në Panorë të Malishevës. Ka studiuar për Letërsi dhe Gjuhë Shqipe në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës. Deri në vitin 1999 ka jetuar në Rahovec, ndërsa pasi mori bursën e Parlamentit Ndërkombëtar të Shkrimtarëve shkoi në Meksikë, në të cilën jeton dhe punon profesor në Akademinë e Krijimtarisë Letrare në Universidad Autónoma de la Ciudad de México (UACM). Bën edhe përkthime të teksteve nga gjuha spanjolle në gjuhën shqipe dhe anasjelltas.

Veprat e Bajrajt janë përkthyer në disa gjuhë dhe janë shpërblyer me çmime të ndryshme. Poezia e tij është përfshirë në disa antologji botërore, në të cilat poeti ka përfaqësuar poezinë shqipe dhe atë meksikane. Ka botuar mbi 15 vepra në gjuhën shqipe, mbi 14 në gjuhë të huaja, ka përkthyer pesë vepra në gjuhën shqipe, ka hartuar dy antologji të poezisë (njërën meksikane e tjetrën shqipe), ka marrë shtatë çmime kombëtare dhe ndërkombëtare.

Kjo monodramë, të cilën po ia botojmë për herë të parë nëntë vjet pas vënies në skenë në Teatrit Kombëtar të Kosovës, në vitin 2011 ka marrë çmimin e parë në konkursin "Katarina Josipi" për dramë origjinale shqipe shpallur nga Ministria e Kulturës e Kosovës.

Vrasja e mushkonjës mund të perceptohet si një rrëfim për konfuzionin në shoqëri, për mungesën e vetëbesimit, për mungesën e shpresës, për kërcënimin nga pushteti autoritar, për dhembjen, për zhgënjimin nga politika dhe nga partitë, për injorancën, për njerëzitet me maska. Ndër të tjera, në të shihet edhe dhembja për atdheun pa dashuri, përplot tradhti e gënjeshtër, me mashtroes kudo në organizata joveveritare, të "përfaqësuesit" e Perëndisë në Tokë, në institucione, rrugë, shtëpi...

Fragment nga parathënia e Agron Shalës

4.90€



E shpërblyer me çmimin e parë në konkursin për dramë shqipe "Katarina Josipi" shpallur nga Ministria e Kulturës e Republikës së Kosovës

VRASJA E MUSHKONJËS
monodramë
nga Xhevdet Bajraj

Me parathënie nga Agron Shalës

E jashtëzakonshme

Po ngordhin qindra elefantë, arsyeja mbetet ende mister

Qindra elefantë janë gjetur të vdekur në Botsvana në Afrikën e Jugut gjatë dy muajve të fundit. Që nga fillimi i majit janë fotografuar rreth 350 kufoma elefantësh në Delta Okavango dhe nuk dihet ende se cili është shkaku.

Dr. McCann, i organizatës bamirëse National Park Rescue, me qendër në Mbretërinë e Bashkuar është shprehur se shkak mund të ketë qenë thatësira dhe vapa e madhe që vendi po përballet këtë kohë.



BARSOLETA E DITËS



Pyet djali babanë polic:

- Babi, sa dhëmbë ka goja?

- 36.

- Jo more babi, se mësuesja na tha se dhëmbë të përhershëm janë 32.

- Po, se i ngatërrova me shkronjat e alfabetit.



Në Kino ABC nuk ka shfaqje

E rrallë

Dy ditë pas dasmës, dhëndri humb jetën dhe 111 të ftuar infektohen me Covid-19



Më shumë se 100 njerëz janë diagnostikuar me Covid-19 pasi morën pjesë në dasmën dhe më pas në funeralin e një 26-vjeçar i cili ishte infektuar me këtë virus. Ai kishte simptomat e Covid-19 ditën e dasmës më 15 qershor dhe piu një paracetamol. Dy ditë pas dasmës, ai ndërroi jetë. Pas

dasmës shumë nga të ftuarit rezultuan pozitivë me Covid-19. Raj Kishor Chaudhary, zyrtari kryesor mjekësor në Patna, ka konfirmuar shpërthimin e një vatre koronavirusi direkt pas martesës. "Deri më tani 111 persona që morën pjesë në dasmë dhe në varrimin e tij janë testuar pozitivisht", ka thënë ai.

FOTO E DITES



Vizita e parë zyrtare e kryeministrit Avdullah Hoti në Shqipëri pritet me ceremoni shtetërore nga homologu shqiptar Edi Rama.



DASHI

Të lindurit e kësaj shenje ka gjasa të ndihen të irrituar gjatë ditës së sotme. Ndoshta kjo mund të ndodhë për shkak të gjendjes financiare.



DEMI

Ekziston mundësia të gaboni teksa bëni disa përllogaritje. Si rezultat i kësaj mund të gaboni gjatë një plani financiar.



BINJAKËT

Mos u tregoni të ashpër kur debaton vetëm për ta mbrojtur idenë tuaj. Madje kjo mund të ndikojë negativisht edhe në gjendjen tuaj psikologjike.



GAFORRJA

Nuk rekomandohet të ndjeni keqardhje për të kaluarën apo të kritikoni veten. Mendoni për të tjera gjëra, që janë më të rëndësishme për ju.



LUANI

Ekziston mundësia të gaboni teksta bëni disa përllogaritje. Si rezultat i kësaj mund të gaboni gjatë një plani financiar.



VIRGJËRESHA

Nuk parashikohen probleme këtë të martë për të lindurit e kësaj shenje. Megjithatë, kjo ditë parashikohet të jetë monotone.



PESHORJA

Ekziston mundësia të bëni një sjellje që do t'i habitë të tjerët. Bëni kujdes, pasi mund të ndikojë në përhapjen e thashethemeve për ju.



AKREPI

Mund të realizoni çdo objektiv tuaj nëse veproni me vendosmërinë. Një i afërm apo një mik mund t'ju ofrojë mbështetje maksimale.



SHIGJETARI

Asgjë nuk do t'ju bëjë përshtypje sot. Do të veproni ashtu sikur dëshironi, pa u menduar dy herë. Beqarët e kësaj shenje rekomandohen të mos tregohen të nxituar.



BRICJAPI

Të lindurit e kësaj shenje do të marrin shumë këshilla të vlefshme sot. Nëse ndërprisni dikë teksa po përpiqet t'ju mësojë, do të ofendohej shumë.



UJORI

Kjo e martë do të karakterizohet si një ditë mjaft e ngjeshur. Bëni gjithçka që mundeni për ta ruajtur qetësinë.



PESHQIT

Kjo ditë premtan të jetë e qetë. Duhet t'u kushtoni vëmendje të veçantë çështjeve profesionale dhe planifikimit financiar. Bëni mirë ta analizoni rrethin e miqve të vjetër.

Kanye West njofton se po kandidon për president në Amerikë



Është e paqartë nëse ai është konsultuar me mikun e tij, Donald Trump, por reperi Kanye West ka njoftuar se është i gatshëm të bëhet president. “Ne tani duhet të realizojmë premtimin e Amerikës duke i besuar Zotit, duke unifikuar vizionin tonë

dhe duke ndërtuar të ardhmen tonë. Unë jam duke kandiduar për president të Shteteve të Bashkuara”, ka shkruar West në “Twitter”. Nuk është e qartë se sa serioz është ai në lidhje me kandidimin, por duket se Kanye do ta sfidojë Trumpin në këtë aspekt.



Charlize Theron thotë se mësimi nga shtëpia ishte periudhë shumë stresuese

Charlize Theron ka folur haptazi për mënyrën sesi ajo po shkollonte në shtëpi dy vajzat e saj mes pandemisë së koronavirusit. Gjatë një interviste me Willie Geist, aktorja 44-vjeçare, bëri shaka se xhirimi i filmave të saj është më i lehtë

sesa shkollimi në shtëpi i vajzave të saj, Jackson tetëvjeçare dhe August, e cila mbush pesë vjet këtë muaj. “Unë do të thosha se sfida më e madhe për mua është shkollimi në shtëpi”, tha ajo, të cilës Geist, një baba i dy fëmijëve, u përgjigj: “Amin”.

Dua Lipa izolohet në ishujt Karaibe me të dashurin e saj



Këngëtarja shqiptare, Dua Lipa, kohët e fundit ka qenë e izoluar për shkak të pandemisë Covid-19. Përkundër kësaj, ajo nuk i ka lënë anash postimet nga më të ndryshmet që tregojnë rrjedhën e përditshmërisë së saj gjatë asaj kohe. Sikurse një pjesë e madhe e popullsisë, duket se edhe

Dua ka vendosur të startojë pushimet në një vend mjaft tropikal. Në një postim në rrjetin social “Instagram”, bukuroshja brune ka ndarë disa imazhe me të dashurin e saj, ndërsa bën të ditur se gjendet në ishujt Karaibe. “Izolimi në ishull”, ka shkruar ajo në përshkrimin e imazheve.

David dhe Victoria Beckham festojnë 21-vjetorin e martesës



David dhe Victoria Beckham kanë festuar 21-vjetorin e martesës së tyre gjatë kësaj fundjave. Çifti tejet i dashur për publikun e gjerë, këtë gjë e kanë bërë të ditur përmes rrjetit social, ku edhe kanë ndarë imazhe duke festuar. David kishte kujtuar takimin e parë me bashkëshorten e tanishme, e cila më parë ishte pjesë e grupit

muzikor “Spice Girls”. Ndërsa ish-këngëtarja dhe njëherësh biznesmenja, Victoria kishte ndarë imazhe të ndryshme ndërsa ka bërë një dedikim të veçantë. “Kush do ta mendonte gjatë këtyre viteve se do të festonim 21 vjetorin e martesës dhe të kemi katër fëmijë të bukur”, ka shkruar ajo në përshkrimin e videos.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Drita nuk lëshon pe në garën për titull



Drita nuk ka gabuar as në xhiron e 28-të në IPKO Superligë, pasi ka triumfuar bindshëm ndaj Llapit (0-4) dhe në këtë mënyrë e ka ruajtur dallimin e pikëve me skuadrat përcjellëse në garën për titull. Fitore kanë shënuar edhe Prishtina, Ballkani dhe Gjilani ndaj Drenicës, Dukagjinit dhe Feronikelit

EPOKA E RE **Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 5 KORRIK - Drita e Gjilanit sigurt po shkon drejt titullit kampion në IPKO Superligën e Kosovës në futboll, pasi të dielën e ka mposhtur Llapin (0-4) në ndeshjen e zhvilluar në stadiumin "Zahir Pajaziti". Fitorja e Prishtinës, e Ballkanit dhe e Gjilanit dukej sikur e kanë shtuar presionin në klubin e Dritës, por ndodhi e kundërta dhe të përzgjedhurit e trajnerit Nuhiu u rikthyen nga Podujeva me fitore. Në minutën e 8 Mërgim Pevqeli realizoi autogol për 0-1, kurse gjashtë minuta më vonë realizoi Kastriot Rezha për 2-0. Në dhjetë minutat e fundit të ndeshjes realizuan Erjon Vucaj dhe Izair Emini për rezultatin 0-4. Pas kësaj fitore, Drita vazhdon të jetë e para me 61 pikë, kurse Llapi është në vendin e gjashtë me 39 pikë. Në ndeshjen tjetër që u zhvillua të dielën mes Ferizajt dhe Trepçës '89 u realizuan shtatë gola, kurse fituese doli skuadra mysafire (2-5). Arb Manaj shënoi dy gola, kurse nga një e shtuan Muja dhe Jashari nga penalltia dhe Ahmeti për skuadrën e Trepçës '89, derisa për vendasit realizuan Kenan Orana dhe Nermin

Hajdareviq. Duhet cekur se Ferizajt në këtë ndeshje iu përjashtuan me karton të kuq dy futbollistë, Gentrit Halili (68) dhe Behar Bardhi (84). Pas tri pikëve të reja, Trepça '89 ka shtuar edhe më shumë gjasat për mbijetesë, duke u renditur në vendin e nëntë me 34 pikë, kurse Ferizajt është një pozitë me poshtë me 26 pikë. Ndërsa të shtunën Prishtina ka realizuar fitore tejet të vështirë në duel me Drenicën (1-0), në ndeshjen e zhvilluar në stadiumin "Fadil Vokrri". Bardhekaltrit kanë arritur ta thyejnë rezistencën e kuqezinjve të Skenderajt vetëm në minutën e katërt të lojës shtesë, kur Ahmed Januzi shënoi me gjuajtje me kokë pas harkimit të Tun Bardhokut. Prishtina ka arritur në kuotën e 57 pikëve. Ndërkohë, Flamurtari ka lëshuar pikë të rëndësishme në garën për mbijetesë, teksa ka barazuar në Vushtrri me rezultat 2-2. Të parët shënuan mysafirët me golin e Zeqirit në minutën e 7, por vushtrriasit reagan shpejt, ngaqë vetëm katër minuta më vonë barazoi Fazliu. Flamurtari shënoi sërish në minutën e 36 nëpërmjet Stullqakut, por as këtë herë nuk arriti ta ruajë epërsinë, ngaqë në minutën e 41-të

baraspeshën në rezultat e riktheu Sie. Pas këtij barazimi, Flamurtari ka 37 pikë në pozitën e tetë, kurse Vushtrria mbetet me 17 pikë në pozitën 11 dhe pa gjasa për t'iu shmangur rënies nga elita.

IPKO Superliga		
Llapi-Drita		0-2
Ferizaj-Trepça '89		2-4
Prishtina-Drenica		1-0
Feronikeli-Gjilani		0-2
Dukagjini-Ballkani		1-5
Vushtrria-Flamurtari		2-2
Tabela		
1. Drita	28	61 pikë
2. Prishtina	28	57
3. Ballkani	28	56
4. Gjilani	28	55
5. Feronikeli	28	44
6. Llapi	28	39
7. Flamurtari	28	37
8. Drenica	28	35
9. Trepça '89	28	34
10. Ferizaj	28	26
11. Vushtrria	28	17
12. Dukagjini	28	10
Në xhiron e radhës takohen: Gjilani-Prishtina, Ballkani-Llapi, Drenica-Ferizaj, Drita-Feronikeli, Trepça '89-Vushtrria, Flamurtari-Dukagjini.		

SHKURT

Dardana vazhdon bashkëpunimin me Pajazitin

Sedat Pajaziti do të jetë trajner i Dardanës nga Kamenica edhe në edicionin 2020/21. Lajmi është bërë me dije nga kryetari i klubit, Sevi Kastrati. "Kemi arritur marrëveshje me Pajazitin dhe ai do të jetë trajner i Dardanës në sezonin e ardhshëm", ka deklaruar Kastrati për "Olle". "Jemi në negociata me 3-4 futbollistë cilësorë dhe besoj se do të arrijmë marrëveshje. Pas vendimit të FFK-së për ndarjen e tabelës në dy grupe, synimi ynë do të jenë dy pozitat e para në renditje", ka shtuar Kastrati. Dardana është inkuadruar në Ligën e Parë në edicionin që e lamë pas.

Nuhiu shënon në humbjen e Sheffieldit

Atdhe Nuhiu nuk ka pasur aktivizimin e dëshiruar këtë sezon, por duket se dalëngadalë po provon të ngrihet dhe të fitojë minutat e dëshiruara. Sulmuesi nga Kosova të dielën është aktivizuar në minutën e 70 nga trajneri dhe më pas ka mundur t'ia shpërblejë trajnerit, por pa arritur ta evitojë humbjen e skuadrës së Sheffield Wednesday ndaj Swansea City (2-1). Ai ka arritur të shënojë në minutat e fundit të ndeshjes, duke ngushtuar diferencat në 2-1, por në fund goli i tij ka mbetur vetëm në statistika, pasi skuadra e tij nuk ka mundur të barazojë në aq pak kohë të mbetur. Ky ishte goli i pestë i sulmuesit të Kosovës, i cili deri tani ka dhuruar edhe dy asistime në 12 ndeshje, ku është aktivizuar si titullar.

Bayerni fiton Kupën e Gjermanisë

Pak pasi fitoi titullin e kampionit në ligë, Bayern Munichu ka mposhtur Bayer Leverkuseni për të triumfuar në Kupën e Gjermanisë. Bayerni fitoi me rezultat 4-2. Robert Lewandowski shënoi dy herë, ndërsa nga një gol realizuan David Alaba dhe Serge Gnabry për bavarezët, teksa Sven Bender e Kai Havertz shënuan për Leverkusenin. Kjo ishte hera e 20-të që Bayerni e fiton këtë kupë.

Lojtari anglez mbytet duke notuar në liqen

Një lajm tronditës ka ardhur nga ShBA-ja, teksa ish-lojtari i Nottingham Forestsit, Derrik Otim, është mbytur në një liqen në Karolinën e Jugut. Futbollisti anglez ishte duke notuar në liqen teksa aty është mbytur duke i tronditur të gjithë. Lajmi është konfirmuar nga vetë klubi i Nottinghamit, që nëpërmjet një postimi në profilin zyrtar, u shpreh ngushëllime familjarëve të 24-vjeçarit. Në liqenin ku u mbyt futbollisti Otim janë mbytur edhe shumë të tjerë dhe për këtë arsye ai quhet një nga më të rrezikshmit në Karolinën e Jugut.

Flick: Lewandowski e meriton 'Topin e Artë'

MUNCHEN, 5 KORRIK - Trajneri i Bayern Munchenit, Hansi Flick, ka thënë se Robert Lewandowski mund ta fitojë "Topin e Artë", pasi e ka mbyllur sezonin e tij kombëtar me 51 gola. Deri më tani polaku ka fituar titullin kampion të

Bundesligës dhe Kupën e Gjermanisë me "bavarezët" në sezonin aktual, ndërsa synon edhe Ligën e Kampionëve. "51 gola janë një arritje fantastike për çdo sulmues në botë. Të dy golat e Lewandowskit në finalen e Kupës së Gjermanisë

ishin të shkëlqyer. Mënyra se si ai e merr topin dhe se si shënon është unike. Sigurisht ka pasur edhe pak fat, por ka shumë besim në cilësitë e tij. Nëse ka shënuar 34 gola në Bundesligë këtë sezon, atëherë mund të mendoni se

një lojtar nga kampionati ynë mund të bëhet fituesi i 'Topit të Artë'. Rivalët e tij janë jo pak mbrapa në këtë drejtim. Ai i ka hedhur të gjitha themelet me arritjet e këtij viti, ndaj do ta meritonte çmimin prestigjioz", ka thënë Flick.



Shatri realizoi rrugëtimin sfidues 257 kilometra nga Prishtina në Tiranë



Prishtinë, 5 korrik - Atleti Fikret Shatri ka realizuar rrugëtimin sfidues 257 km nga Prishtina në Tiranë. I stërlodhur dhe me lot gëzimi, por tejet krenar në shpirt, atleti Fikret Shatri ka arritur te sheshi "Skënderbeu" në Tiranë, duke realizuar rrugëtimin sfidues. 45-vjeçari nga Istogu vrapoi 257 km, derisa shkaku i një lëndimi të vogël kilometrat e fundit i përfundoi duke ecur. Shatri arriti rreth orës 15:30 te sheshi "Skënderbeu" në Tiranë, pas 45 orësh rrugëtim. Ai ishte nisur më 2 korrik në orën 18:00 nga sheshi "Skënderbeu" në Prishtinë. Shatri u ndie i lumtur dhe tejet i emocionuar, derisa falënderoi të gjithë ata që

e shoqëruan gjatë këtij rrugëtimi, por edhe sponsorët. "Jam i lumtur për faktin se jo që nuk dështova unë, por nuk dështuan miqtë e mi. I përhëndes të gjithë ata njerëz që i kam lënë pa gjumë. Këmbët u lënduan për shkak të asfaltit", ka thënë Shatri. Në përkrahje të tij ishte edhe sekretari i përgjithshëm i Komitetit Olimpik të Kosovës, Shasivar Haxhijaj, i cili iu bashkua në dhjetëra kilometrat e fundit, pastaj presidenti i Komitetit Olimpik Kombëtar të Shqipërisë, Viron Bezhani, atletët e klubit Prishtina "Trail Runner", "Gërmia 555", të cilët ishin gjatë tërë kohës së bashku,

klubi "Maraton Albania" nga Shqipëria, miq dhe familjarë të tij. "Në emër të Komitetit Olimpik të Kosovës mora pjesë në vrapimin sfidues të Fikret Shatrit. Fikreti sot bëri kulmin e karrierës së tij duke bërë histori jo vetëm në sportin e Kosovës, por edhe atë ballkanik e më gjerë. Personalisht e falënderoj Fikretin që na dha këtë kënaqësi që ta shijojmë edhe ne këtë sfidë. Sot u ndjeva vërtet i lumtur, për dhjetëra kilometrat që i bëra me të sepse, mbi të gjitha, evokuam kujtime të ecjeve në kohë dhe rrethana shumë më të rënda për Kosovën", u shpreh Haxhijaj. KOK-u ishte sponsori kryesor i rrugëtimin të Shatrit.

Bottas fiton garën, dështojnë Hamiltoni dhe Vetteli

ZELTWEG, 5 KORRIK - Formula 1 është rikthyer me emocione të mëdha. Valtteri Bottas ka triumfuar në çmimin e madh të Austrisë. Piloti i Mercedes ka dominuar provat e lira dhe nuk e vuri për asnjë moment në dyshim fitoren e tij në këtë garë. Vendi i dytë në podium shkoi për djaloshin e Ferrarit, Leclerc. Ky i fundit e nisi garën nga vendi i shtatë, por fati ishte me të me daljen nga gara të rivalëve të tij, por dhe penalizimeve të tyre. Vendi i tretë shkon për Norris, i



cili arrin për herë të parë në karrierë të ngjitet në podium. Humbësi i madh është Lewis Hamilton. Anglezi zhvilloi një garë të mirë sepse e nisi nga vendi i pestë pas penalizimit të marrë në provat e lira dhe ia doli

të arrinte në vendin e dytë. Ai rivalizoi me shokun e tij Bottas, por momenti vendimtar ishte kontakti me Albion. Kampioni i botës e nxori nga pista dhe u penalizua me 5 sekonda. Kjo bëri që Hamilton ta mbyllë në vendin e katërt. Vetëm vendi i 10-t për Vettelin që kaloi një garë me shumë probleme. Zhgënjën Max Verstappen që lihet në baltë nga makina e tij Red Bull. Belgu doli nga gara në xhiron e 14 sepse makina e tij nuk i përgjigjej.

SHKURT

Xavi rinovon kontratën me Al-Saddin

Ish-mesfushori i skuadrës së Barcelonës, Xavi Hernandez, do të jetë në krye të Al-Sadd deri në fund të sezonit 2019/20. Lajmin për rinovimin e kontratës e ka konfirmuar skuadra përmes faqes zyrtare. Xavi lidhej me një kalim të mundshëm te Barcelona, si zëvendësues i Quique Setien, por duket se ai ka fokusin tek Al-Sadd. Megjithatë, raportime të 'Mundo Deportivo' bëjnë të ditur se në kontratën e nënshkruar ka një klauzolë që lejon Xavin të largohet nga Al-Sadd, nëse në pyetje është Barcelona. Ndërkohë, në 'Camp Nou' në krye të stolit vazhdon të jetë Quique Setien.

Katër klube angleze në garë për Jamesin

James Rodriguez do të largohet në verë nga Real Madridi, pasi nuk ka besimin e trajnerit Zinedine Zidane. Kolumbiani po luan shumë pak që pas rikthimit nga Bayern Munich dhe fati nuk ka qenë me të, ai është dëmtuar shpesh. "Marca" shkruan se madrilet nuk duan ta humbasin me kosto zero sezonin e ardhshëm, prandaj duan ta shesin në këtë verë. Prestigjiozja spanjolle bën me dije se Evertoni, Arsenali, Manchester Unitedi dhe Wolves duan shërbimet e Jamesit.

Evertoni planifikon rikthimin e Stonesit

Drejtuesit e Evertonit po mendojnë seriozisht rikthimin në skuadër të mbrojtësit anglez John Stones, i cili tani ka përfunduar jashtë planeve të trajnerit Pep Guardiola. Futbollisti 26-vjeçar është zgjedhja e fundit në hierarki për trajnerin spanjoll, i cili shpesh ka kthyer në mbrojtje mesfushorin Fernandinho, duke mbajtur në bankinë anglezin dhe ka dhënë miratimin për shitjen e tij në fund të sezonit. Pasi kanë marrë miratimin e Carlo Ancelottit, drejtuesit e Evertonit kanë nisur negociatat me "citizens", ndërsa marrëveshja për rikthimin e Stones në Liverpool mund të mbyllet për më pak se 20 milionë paundë.

Van Dijk: Klopp ishte arsyeja pse erdha në Liverpool

Qendërmbrojtësi holandez Virgil van Dijk konsiderohet mbrojtësi më i mirë në Premierligë. Ai kaloi te Liverpooli nga Southamptoni për shkak se trajner ishte Jurgen Klopp. "Kam pasur mundësinë të kaloj te Chelsea dhe Manchester City. Kur krahason klubet, sheh historinë, qytetin, skuadrën aktuale, planet për të ardhmen e afërt, por më me rëndësi, trajnerit - dhe Jurgen Klopp është një arsye e rëndësishme pse zgjedha Liverpoolin", ka thënë Van Dijk. "Klopp ka diçka speciale. A është energjia e tij? Imazhi i përgjithshëm? Ndonjëherë ulem dhe mendoj se çfarë bën ai që ka diçka më shumë se të tjerët", ishin fjalët e holandezit. Van Dijk ka kaluar periudhën më të mirë të karrierës së tij me Liverpoolin, duke fituar Ligën e Kampionëve vitin e kaluar, por edhe Premierligën këtë vit. Holandezi ishte në garë me Lionel Messin për 'Topin e Artë', por argjentinasin doli fitues në fund.

Inzaghi: Humbja nga Milani na rëndon shumë në klasifikim

Lazio me humbjen nga Milani (0-3) ka mbetur shtatë pikë pas Juventusit. Trajneri Simone Inzaghi e pranon se humbja e ka kushtuar shumë skuadrës së tij. "Kjo humbje na rëndon shumë në klasifikim, por e dinim që kishim vështirësi objektive. Nuk kishim as fat, pasi pësuam gol me devijim dhe Strakosha për pak sa nuk e preku penalltinë. Kishim dy raste për t'u kthyer në lojë. Fatkeqësisht, nuk mund të bëj rotacion në këto çaste. Katër ndeshjet e ardhshme në dy javë do të jenë shumë të vështira", ka thënë Inzaghi.


RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË





Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi


Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë









www.facebook.com/gjejpuneshpeite





Lume's Details


Estetik & Depilim

 044 900 978 | 045 681 898

 Sallon Depilimi Lume's Details

 lumesdetails

 Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

Haqif Fanaj shpall të pavlefshme diplomën me NR.1820 në Fakultetin Filozofik, dega e Historisë në UP. Të lëshuar me 31.08.1999.

- ▶ Blend Bejta shpall të pavlefshme ID-kartelën E-17/159 të kolegjit "Biznesi".
- ▶ Florim Hajdari shpall të pavlefshme ID-kartelën E-17/119 të kolegjit "Biznesi".
- ▶ Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.23-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkudjesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokalim më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- ▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- ▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- ▶ Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- ▶ Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049/44-888-801 (viber)
- ▶ Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.
- ▶ Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.
- ▶ Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.
- ▶ Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo , ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet . Për info: 045/699-221.
- ▶ Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qërimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

- Quality & Sales Award Recipients**
[Listed in alphabetical order]
- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
 - ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
 - ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
 - ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
 - ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
 - ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
 - ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
 - ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
 - ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
 - ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

